

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

LIGJI NR. 2002/7

PËR TELEKOMUNIKACIONIN

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregulloren nr.2001/9 të dt. 15 majit 2001 Mbi Kornizën Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, veçanërisht nënët 5.1 (h), 5.7, 9.1.26.(a), 9.3.3, 11.2 dhe tutje;

Në bazë të Rregullores nr.1999/1 dt. 25 korrik 1999 Mbi Autorizimet e Misionit të Përkohshëm të OKB-së në Kosovë; të plotësuar dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 Mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, të plotësuar; dhe

Duke pasur parasysh nevojën për përmirësimin e sektorit të telekomunikacionit në Kosovë: me krijimin e Autoritetit të Pavarur Rregullator i cili do të jetë përgjegjës për licensimin, rregullimin dhe menagjimin e ofruesve të shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë; inkurajimin e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe konkurrencën lojale në përputhje me dispozitat në fuqi, rregullimin e standardeve unike për të gjithë ofruesit e shërbimeve në Kosovë dhe mbrojtjen e konsumatorëve të këtyre shërbimeve:

Nxjerr ligjin vijues:

Kapitulli 1
Dispozitat e përgjithëshme

Nëni 1
Fushveprimi dhe qëllimi

(1) Ky ligj qeveris të gjithë shërbimet e telekomunikacionit dhe të gjithë ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë dhe do të krijojë një ambient ligjor, rregullator dhe transparent, i cili do të promovojë investimet dhe konkurrencën e lirë, për t'i përmbushur nevojat e të gjithë shfrytëzuesve për shërbime të telekomunikacionit.

(2) Ky ligj, si dhe të gjithëa aktivitetet implementuese, duhet t'i marrin parasysh udhëzimet dhe rregulloret e Bashkimit Evropian si dhe standardet dhe praktikat tjera ndërkombëtare të telekomunikacionit të cilat kanë të bëjnë me promovimin e kushteve transparente të hyrjes/plasimit në treg dhe të një tregu me konkurrencë.

Nëni 2

Definicionët dhe rregullat e interpretimit

(1) Definicionët: termet në vijim, qofshin ato në njëjës apo shumës, do të kenë kuptimin e cekur në vijim:

“Kuvendi” nënkupton trupin legjislativ të themeluar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, më datën 15 maj 2001, “mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë”.

“Autorizimi” nënkupton lejen zyrtare me shkrim, të lëshuar nga ART-i, i cili e verifikon qëllimin e një personi për të ofruar shërbime publike të telekomunikacionit.

“Transmetimi” nënkupton emitimin dhe shpërndarjen e kanaleve radio apo televizive me qëllim të pranimit të drejtpërdrejtë nga publiku. Transmetimi është shërbim një-drejtëmësh i telekomunikacionit që nuk do të përfshijë edhe drejtimin kthyes nga shfrytëzuesi tek ofruesi i shërbimeve.

“Rregullorja mbi transmetimin” nënkupton Rregulloren e UNMIK-ut 2000/36 “Mbi Liçencimin dhe Rregullimin e Mediave Transmetuese në Kosovë.”

“Komisioni për transport, postë dhe telekomunikacion” (“Komisioni”) nënkupton komisionin përgjegjës të Kuvendit për shqyrtimin e çështjeve që i përkasin sektorit të telekomunikacionit.

“Conference Européenne des Administration des Postes et des Telecommunications” (“CEPT”) nënkupton Konferencën Europianë të Administratave të Postave dhe Telekomunikacionit, si trup i standardeve europianë, i cili promovon harmonizimin e parametrave teknik dhe veprues ndërmjet ofruesve të shërbimeve të telekomunikacioneve dhe atyre postale nëpër tërë Europën.

“Informatat konfidenciale” nënkupton të gjithëa dokumentet dhe informatat të tjera, qofshin ato teknike apo afariste, që kanë të bëjnë me dizajnin, rehabilitimin, sigurimin, veprimin, mirëmbajtjen, menaxhimin dhe financimin e veprimit të shërbimeve të telekomunikacionit apo çfarëdo aktiviteti që ka të bëjë me të, mirëpo duke mos përfshirë informatat ekzistuese në sferën publike (domain) apo përndryshe me thyerjen e obligimeve që përmban ky ligj, apo ligjet ose Rregulloret të tjera aplikative të UNMIK-ut.

“Kompatibiliteti elektromagnëtik” nënkupton kapacitetin e një aparature, paisjeje apo sistemi që të operojë në mënyrë të duhur në ambientin e saj elektromagnëtik pa krijuar pengesa të palejueshme elektromagnëtike ndaj asnjë paisjeje tjetër në atë ambient.

“Kushtet e përgjithëshme” nënkuptojnë kushtet në pajtim me të cilat të gjithë ofruesit e shërbimeve në Kosovë do të ofrojnë shërbimet e tyre, dhe të cilat duhet të ri-miratohen me shkrim nga ART-i.

“Ndërlidhja” nënkupton lidhjen fizike dhe logjike të hapsirave të organizatave, të cilat ofrojnë

rrjeta të telekomunikacionit dhe/apo shërbime të telekomunikacionit, me qëllim që t'u lejojnë shfrytëzuesve të një organizatë që të komunikojnë me parapaguesit e një organizatë tjetër, apo t'u mundësohet çasje shërbimeve të ofruara nga një organizatë tjetër.

“Lidhja” nënkupton pikën (nyjen) fizike të lidhjes në rrjet, e cila i mundëson një shfrytëzuesi që t'i qaset një rrjeti publik të telekomunikacionit apo një stacioni radio transmetues, i cili saktëson drejtimin e radios ndërmjet paisjeve të radios.

“Liçensa” nënkupton lejen zyrtare me shkrim, të cilën ART-i i'a lëshon ofruesit të shërbimeve, kjo është leje që nëvojitet në të gjithëa rastet kur ka resurse të kufizuara, duke përfshirë, mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në të drejtën e përdorimit të numrave dhe frekuencave si dhe të hapësirës në pyrgjet, shtyllat dhe në kanale.

“Dhënia me qira e linjës” nënkupton një sërë të mundësive të telekomunikacionit, të cilat i mundësojnë parapaguesit kapacitete transparente të transmetimit ndërmjet pikave lidhëse të rrjetës dhe “linjës së dhënë me qira” do të jetë mundësi e së drejtës së dhënjes së linjës me qira.

“Laku lokal” (Local Loop) nënkupton linjën fizike, e cila lidh pikën lidhëse të rrjetës së parapaguesit me kornizën kryesore të distribuimit, apo paisjet e tjera të ngjajshme në rrjetën publike të telekomunikacionit.

“Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit (“Ministria”) nënkupton njësinë administrative përgjegjëse për çështjet të cilat kanë të bëjnë me sektorin e telekomunikacionit, të themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut No. 2001/19, të 13 Shtatorit 2001, Mbi Degën Ekzekutive të Institucionëve të Përkohshme të Vetë-Qeverisjes në Kosovë.

“Mobile” nënkupton shërbimet publike të telekomunikacionit të cilat ofrohen përmes radios, duke përfshirë në mënyrë specifike telefonët celularë dhe ata satëlitore.

“Pika lidhëse e rrjetës” nënkupton të gjithëa lidhjet fizike dhe specifikat e saja të qasjes teknike, të cilat janë pjesë e rrjetës publike dhe të cilat nëvojiten për qasje në rrjetën publike të telekomunikacionit, apo shërbimeve publike të telekomunikacionit dhe për lidhje efektive përmes një rrjeti të tillë publik.

“Numri” nënkupton një seri të shenjave, numrave, shkronjave apo simboleve të tjera, duke përfshirë edhe kombinimin e tyre për qasje në rrjetën, apo për identifikimin e një rrjete, ofruesi të shërbimeve, pike lidhëse të rrjetës apo çfarëdo elementi tjetër të rrjetës.

“Furnizimi i hapur i rrjetit” “FHR” (“ONP”) nënkupton ofrimi i lirë në rrjet, korniza qenësore rregulluese për sektorin e telekomunikacionit në Evropë, të vendosur në Direktivat e Këshillit të BE-së të 28 Qershorit 1990, et.seq.mbi themelimin e tregut ndërkombëtar, për shërbimet e telekomunikacionit përmes implementimit të kushteve të rrjetës së hapur (90/387/EEC; OJ L 192/1, 24.7.1990).

“Person”– Nënkuptojmë cilido person fizik, juridik apo publik, duke përfshirë këtu edhe korporata, partnëritete, truste, organizata të painkorporuara, ofrues të shërbimeve, Qeverinë apo çfarëdo agjensioni që ka të bëjë me të.

“IPVQ” nënkupton Institucionët e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes, të themeluara sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/19.

“PTK” nënkupton Ndërmarrjen e Postës dhe Telekomit të Kosovës të themeluar sipas

Rregullores së UNMIK-ut 1999/12.

“Rrjeta publike” nënkupton rrjetën e telekomunikacionit, të themeluar apo shfrytëzuar me qëllim të ofrimit të shërbimeve publike të telekomunikacionit.

“Shërbimi publik i telefonisë” nënkupton ofrimin afarist të shërbimit, që përbëhet nga përcjellja e telefonisë së drejtpërdrejtë të zërit, nga ofruesit e shërbimeve publike të telekomunikacionit.

“Radio paisje” nënkupton një mjet, apo pjesë të mjetit, që ka aftësinë e komunikimit përmes emitimit dhe/apo pranimit të radio valëve dhe që përdor spektrin e radio frekuencave të ndara për radio komunikime tokësore/ajërore.

“Radio frekuenca” nënkupton një pjesë të spektrit të frekuencave, që përdoret për radiokomunikime dhe i cili përbëhet nga frekuenca qëndrore dhe përmban shiritin e definuar të valëve të radio frekuencës përmbi dhe nën.

“Ofruesi i shërbimeve” nënkupton cilën do ndërmarrje që ofron çfarëdo shërbimesh të telekomunikacionit, cilindo shfrytëzues apo ndërmarrje; ky term gjithëashtu është përshkruar edhe si ofrues i shërbimeve të telekomunikacionit në këtë ligj.

“Mjet i vetë-punuar” të gjithëa pajisjet e telekomunikacionit, të cilat futen në punë nga përdoruesi në baza të vazhdueshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përdorimin për hobi, arsim dhe studim dhe aplikacionet zhvillimore por duke mos përfshirë prodhimin industrial.

“Parapaguesi” nënkupton ata persona të cilët mbajnë një kontratë të vlefshme me ofrues të shërbimeve publike të telekomunikacionit për shfrytëzimin e shërbimeve të tyre.

“Telekomunikacionët” nënkuptojnë çfarëdo forme të transmetimit apo pranimit të shenjave, sinjaleve, tekstit, fotografisë, zërit apo informatave të tjera, përmes telave, fijeve optike, radios apo mjeteve të tjera elektromagnetike.

“Rrjetat e telekomunikacionit” nënkupton sistemin e transmetimit, duke përfshirë edhe komutacionët telefonike dhe paisjet e tjera, që ndihmojnë në transferimin e sinjaleve ndërmjet pikave specifike lidhëse të rrjetave, përmes telave apo radio valëve, ose përmes mjeteve optike apo mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë këtu edhe rrjetat satëlitore, rrjetat tokësore fikse dhe mobile, të zërit apo të të dhënave, rrjetat e transmetimit radio dhe televiziv, si dhe rrjetat kabllorike televizive.

“Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit” (“ART”) nënkupton, organin e pavarur rregullator të themeluar sipas këtij ligji, për të rregulluar dhe për t’u kujdesur për zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit në Kosovë.

“Shërbimet e telekomunikacionit” nënkupton sistemet e transmetimit dhe aty ku është e mundshme paisjet e komutacionëve telefonike si dhe resurset e tjera të cilat mundësojnë dërgimin e sinjaleve ndërmjet pikave të definuara fundore përmes telit, radios, fijeve optike apo mjeteve të tjera elektromagnetike.

“Paisja terminale” nënkupton paisjen e dedikuar për lidhje të drejtpërdrejtë apo indirekte me pikën fundore të një rrjete, me qëllim të dërgimit, procesimit apo marrjes së informatave, duke mos përfshirë këtu paisjet e dedikuara për ofrimin e qasjes në programe zbavitëse, në radio apo kabllor TV, përveç nëse një paisje e tillë mund të përdoret për qasje në shërbimet e telekomunikacionit.

“Komisionëri i përkohshëm për media” nënkupton autoritetin për rregullimin e sektorit transmetues të Kosovës, të definuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/36 të datës 17 Qershor 2000 mbi liçencimin dhe rregullimin e mediave transmetuese në Kosovë.

“Shërbimet universale” nënkupton ato shërbime, të cilat përbëjnë furnizimin minimal me shërbime të telekomunikacionit të kualitetit të definuar, në të cilin të gjithë parapaguesit, me kërkesë të tyre, mund të kenë qasje në çmimin e qasjes, pa marrë parasyshtë vendin e tyre të banimit apo të veprimit.

“Parapaguesit” nënkupton personat, të cilët përdorin apo kërkojnë shërbime të telekomunikacionit si shfrytëzues të fundit, apo ofruesit e shërbimeve që shfrytëzojnë shërbimet e telekomunikacionit të tjerëve; këta persona gjithëashtu quhen parapagues në këtë ligj.

“Faqe në internet” nënkupton të dhënat elektronike, tek të cilat ka mundësi të qasjes përmes internetit publik dhe që janë të përcaktuara nga Kërkuesi Universal i Shënimeve (URL).

“Linja pa tela/ajrore” nënkupton shërbimet publike të telekomunikacionit, të ofruara përmes radio frekuencës, apo lakut të fiksuar lokal apo lakut optik.

“Linja me tela” nënkupton ofrimin e shërbimeve publike të telekomunikacionit përmes fijeve të bakrit apo mjeteve të tjera fizike, duke përfshirë në mënyrë specifike ato shërbime tradicionale themelore që ofron PTK-ja, përmes fijeve të përdredhura të bakrit.

“Rajon rural” – është rajon me popullatë të rallë ku predominojnë aktivitetet ekonomike që përfshinë prodhimin bujqësor, serrat, fermat dhe pyjet. Në Kosovë, termi “rajon rural” në mënyrë specifike nuk përfshinë shtatë (7) qendrat të mbëdha urbane dhe fshatra me më shumë se 1000 banorë.

“Bordi Mbikqyrës”- nënkupton, bordin që themelohet nga MTPT për mbikqyrjen e PTK-së.

“AKM” – Agjencia Kosovare për Mirëbesim siç është përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12.

Nëni 3 Autoritetet dhe kompetencat

(1) Përgjegjësitë e sektorit të telekomunikacionit në Kosovë biejnë mbi njësitë në vijim:

a) Ministria, do të mbajë përgjegjësinë për hartimin e politikave për këtë sektor, duke përfshirë edhe hartimin e legjislacionit, si dhe për ushtrimin e të gjithëa pushteteve që i janë transferuar sipas Kornizës Kushtetuese.

b) ART, i themeluar nga ky ligj, si një trup i pavarur përbrenda IPVQ, mban përgjegjësinë për implementimin e politikave të IPVQ dhe Ministrisë, të udhëhequra nga ky ligj si dhe të gjithëa pjeset legjislative në pajtim me këtë ligj.

c) UNMIK-u, përmes PSSP, mban përgjegjësitë të cilat i janë rezervuar sipas Kornizës Kushtetuese, duke përfshirë këtu:

- (i) Autorizimin mbi menagjimin e mjeteve publike të telekomunikacionit, duke përfshirë por duke mos kufizuar në menaxhimin e pajisjeve themelore të PTK-së, përmes Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM), në bashkëpunim me IPVQ në përputhje me Rregulloren Nr. 2002/12, të datës 13 Qershor 2002 të UNMIK-ut mbi “Themelimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit”;
- (ii) menaxhimin e radio frekuencave, të cilat ekzekutohen nga Zyra për Menaxhimin e Frekuencave (ZMF), si dhe disa funksione të caktuara administrative zbatohen nga institucionet e përkohshme të vetqeverisjes dhe nga organet e pavarura rregullatore përkatëse.
- (iii) rregullimi i industrisë së transmetimit, e cila ekzekutohet nga Komisioneri i Përkohshëm për Media (KPM).
- (2) ART-i, do të koordinojë të gjithë aktivitetet transmetuese me Komisionerin e Përkohshëm për Media si dhe me autoritetet e tjera në përputhje me dispozitat e Rregullores mbi transmetimin.
- (3) ART-ja do të caktojë ofruesëve të shërbimeve, burime spektrale të cilat në mënyrë të veçantë janë ndarë nga UNMIK-u.
- (4) ART, me vetëdëshirë mund të kërkojë nga ofruesit e shërbimeve kontratat ndërkombëtare dhe ti shqyrtojë ato, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit dhe të paisjeve ndërmjet njësive afariste aktive në Kosovë. ART-ja nuk ka autoritet për të lidhur marrëveshje me shtetet ose organizata ndërkombëtare”
- (5) Ministria do të kërkojë që PSSP-ja në emër të UNMIK-ut të bëjë marrëveshje me shtete apo organizata multilaterale që i përkasin sektorit të telekomunikacionit, si dhe të gjithë dokumentet nën mbikqyrjen e PSSP-së e që kanë të bëjnë me marrëveshjet ndërkombëtare, të bëra në emër të UNMIK-ut për sektorin e telekomunikacionit. Si pjesë e procesit konsultues në këto çështje, Ministria mund të kërkojë që si palë e interesuar të marrë pjesë në diskutimet dhe në negociatat e udhëhequra nga PSSP me shtetet dhe organizatat multilaterale, të cilat kanë për qëllim arritjen e një marrëveshje të tillë.

Kapitulli 2 **Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit**

Nëni 4 Themelimi i ART-it

- (1) Autoriteti Regullator i Telekomunikacionit (“ART”) që këtu themelohet si autoritet i pavarur, jo-profitabil brenda Ministrisë, do të zbatojë politikën e IPVQ-së dhe Ministrisë, gjithmonë në pajtim me këtë ligj si dhe në pajtim me të gjitha legjislacionet të nxjerra për implementimin e këtij ligji.
- (2) ART-i do të promovojë dhe lehtësojë ofrimin e shërbimeve të mjaftueshme dhe të kënaqshme vendore dhe ndërkombëtare të telekomunikacionit, si dhe të shërbimeve të tjera, të përfshiera në rregulloret për transmetim, duke marrë parasysh që sidoqoftë promovimet dhe lehtësimet e tilla të mos shtrihen edhe në shërbimet pa pagesë.

(3) ART-i do të udhëhiqet sipas këtij ligji, dhe do të hulumtojë nevojën për promovimin e shërbimeve univerzale në pajtueshmëri me parimet e parashtruara në kapitullin 8 të këtij ligji.

(4) ART-ja është ka kompetencat për nxjerjen e rregullave administrative dhe udhëzime për implementimin e këtij ligji.

Nëni 5

Fondet, buxheti, revizioni dhe raportimi

(1) Ministria do të propozojë dhe Kuvendi do të miratojë shumën e buxhetit fillestarë të ART-it dhe do të ndajë fonde të mjaftueshme nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës që të financojë themelimin e ART-it dhe vitin e parë të veprimtarisë së tij.

(2) Më tutje, ART-i do të jetë i vetë-financuar, duke mbuluar shpenzimet e arsyeshme dhe përkrahjen adekuatë administrative dhe teknike, shumë kjo e cila nuk do të jetë më e vogël se shumata e ndarë vitin paraprak, përveç nëse kuvendi vendos ndryshe.

(3) Veprimet e ART-it do të financohen nga paratë të cilat do të mbledhen përmes aplikimit transparent të tarifave rregullative në pajtim me këtë ligj, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- (a) autorizimet;
- (b) liçensimet;
- (c) dhënjën e numrave, dhe
- (d) akordimin e të drejtës për përdorim të spektrit frekuencor.

(4) Të gjithëa fondet e mbledhura nga ART-i, do të depozitohen në një llogari të krijuar enkas për përdorimin e tij në Autoritetin e Bankave dhe Pagesave të Kosovës (BPK). ART-i do të përdorë standarde të kontabilitetit për të gjithëa llogaritë e saja në pajtim me ligjet e Kosovës. Teprica e krijuar nga taksat, liçensimet dhe autorizimet që e kalojnë shumën e buxhetit të miratuar nga Kuvendi për ART-in, do të derdhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

(5) ART-i do të emërojë një auditor të kualifikuar të jashtëm, që të bëjë revizionimin e llogarive të tij në pajtim me ligjet e Kosovës.

(6) ART-i do t'i dorëzojë buxhetin për shqyrtim apo miratim Kuvendit, jo më pak se 2 muaj para fillimit të secilit vit fiskal.

(7) Jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së secilit vit fiskal, ART-i do të pregatisë dhe do t'i dorëzojë Kuvendit një raport vjetor që përmban detaje financiare, që i përkasin aktiviteteve të ART-it për vitin paraprak. Një version elektronik i atij raporti, do të publikohet në faqen zyrtare të ART-it në internet.

(8) Ministria do t'i ofrojë ART-it përkrahjen administrative të nevojëshme për të filluar punën e tij zyrtare, duke përfshirë, mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në, shfrytëzimin e zyrave, shërbimeve komunale, paisjeve të zyrës, shërbimeve të telekomunikacionit, personëlit

administrativ, si dhe përkrahje në financa dhe kontabilitet.

Nëni 6 Veprimet e bordit

- (1) Autoriteti ligjor i ART-it, do të mbesë në bordin e tij. Vendimet e bordit do të mirren në mënyrë transparente, të pavarura nga ndikimet politike, industriale apo nga ndikimet tjera.
- (2) Bordi do të përbëhet nga pesë (5) anëtar.
- (3) Anëtarët e Bordit Rregullativ do të paguhen në pajtim me skemën aplikative të pagave për anëtarët e Kuvendit, e cila do të pasqyrohet në buxhetin fillestar të ART-it dhe do t'i prezentohet Kuvendit për miratim.
- (4) Ministri i Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit në konsultim me Kryeministrin, do të emërojë një anëtarë të bordit që të jetë kryesuesi i atij bordi. Kryesuesi, do të udhëheqë takimet dhe aktivitetet e bordit, do të merr përgjegjësinë për administrimin e ART-it, si dhe do të mbikqyrë zgjedhjen, punësimin, përfundimin e kontratave si dhe administrimin e përgjithshëm të të punësuarve.
- (5) Secili anëtar i bordit rregullator do të shërbejë me një mandat prej 5 vitesh nga data e emrimit të tij. Numri i emërimeve për një anëtar do të jetë vetëm dy mandate. Për t'u siguruar që mandatët e jo më shumë se 2 anëtarëve të skadojnë brenda një viti kalendarik, mandatët e anëtarëve fillestarë mund të shtyhen.
- (6) Shumica e anëtarëve ekzistues të bordit, do të formojnë bazën për udhëheqjen e punëve të bordit. Secili anëtar, duke përfshirë edhe kryesuesin, do të kenë të drejtë në vetëm një votë, me votimin nga shumica e anëtarëve për një punë, do të ndërmerret çfarëdo lloj aktiviteti. Në rast se vie deri te votimi i barabartë ndërmjet anëtarëve, kryesuesi do të jap votën përfundimtare e cila do të jetë vendimmarrëse.
- (7) Bordi do të takohet aq shpesh sa është e nevojshme, mirëpo jo më pak se një herë gjatë secilit muaj kalendarik, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve të tij. Takimet e bordit do të jenë të hapura për publikun, përveç nëse nuk vendoset ndryshe nga bordi ose në bazë të udhëzimeve të tjera administrative ose në baza të rastësishme.
- (8) Bordi është i autorizuar të adoptojë politika me shkrim të cilat përcaktojnë detyrat dhe funksionët e caktuara për personëlin e ART-it.
- (9) Përmbledhjet e të gjithëa takimeve të ART-it, do të jenë të hapura për shqyrtim publik.

Nëni 7 Kualifikimi, konfirmimi, dorëheqja dhe largimi i anëtarëve

- (1) Anëtarët e bordit rregullator, me rekomandim të Ministrisë së Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit, i propozon Qeveria dhe do të emërohen nga Kuvendi.
- (2) Lista e personave të emëruar për të qenë pjestarë të bordit të parë, do t'i dorëzohet Kuvendit për shqyrtim jo më vonë se 30 ditë pas ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Anëtarët e bordit duhet të kenë kualifikimin superior shkollor dhe njohuri të specializuara për telekomunikacion nga fusha e politikës, frekuencave, interkonëksionit, tarifave, jurisprudences, ekonomisë, standardizimeve apo të kenë së paku 10 vjetë përvojë punë në sektorin e telekomunikacionit.

(4) Anëtarët e bordit do të punojnë për ART-in me orar të plotë dhe nuk do të marrë pjesë në asnjë aktivitet tjetër komercial pa marrë parasysh nëse antari mer apo jo kompensim për një aktivitet të tillë. Si kusht për pranimin e pozitës, nëse ndonjë anëtar punon për ndonjë zyrë, atëherë atij do ti duhet që të kërkojë dorëheqje nga një zyrë e tillë apo çfarëdo vendpunimi tjetër. Gjithëashtu, nga një anëtar do të kërkohej që të ndalë çfarëdo aktiviteti afarist privat apo aktivitete dhe interesa tjera financiare në ndërmarrjet që janë nën jurisdiksionin e bordit, si dhe përndryshe të pajtohet me dispozitat mbi standardet e sjelljes të ART-it.

(5) Me dy të tretat e votave të anëtarëve, bordi do të largojë një anëtar në bazë të jo - kompetencës profesionale apo sjelljeve të këqija. Bazat specifike për largimin apo dorëheqjen e detyrueshme të një anëtari do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen vetëm në kriteret vijue:

- (a) vdekja;
- (b) paaftësia psiqike apo fizike
- (c) diskualifikim sipas dispozitave të këtij ligji
- (d) falimentimi apo paaftësia paguese
- (e) mungesa e paarsyestuar në tri mbledhje zyrtare apo të zakonshme të njëpasnjëshme të ART-it
- (f) dënim për kundravajtje apo vepër penale
- (g) interes personal, bashkëshortor apo interes të drejtpërdrejtë familjar në ndonjë licensë të lëshuar sipas këtij ligji; dhe/apo,
- (h) përfitime financiare nga çfarëdo paisje e telekomunikacionit apo cilido furnizues apo ofrues i shërbimeve.

(6) Çdo shakrkim nga detyra në pajtim me nenin 7 (5) do të jetë objekt i shqyrtimit nga Kuvendi.

(7) Nëse një anëtar i bordit dëshiron që të tërhiqet nga bordi, ai duhet që 3 muaj më parë të dërgojë një njoftim për dorëheqje tek kryesuesi i bordit.

Kapitulli 3

Autoriteti dhe parimet e veprimtarisë së ART-it

Nëni 8

Politikat operative dhe standardet e mirësjelljes

(1) Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ART-i do të adoptojë rregullat e veta operative, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në, punësime dhe politika të punësimit të cilat janë jo-diskriminuese dhe që bazohen në përshtime të shkruara punë. Të gjithë rregullat administrative që adoptohen nga ART-i, do të vihen në dispozicion për inspektim nga publiku.

(2) Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ART-i do të adoptojë standarde të mirësjelljes për anëtarët dhe personëlin, standarde këto që do të

sigurojnë që ata i kryejnë detyrat e tyre me ndershmëri dhe mirë, duke evituar konfliktet e interesit. Standardet e tilla të mirësjelljes do të përfshijnë dispozita të veçanta mbi;

- (a) përvetësimin e çfarëdo përfitimi, nga çfarëdo pajisje e telekomunikacionit apo pranimin e çfarëdo të ardhurash financiare nga cilitdo furnizues apo ofrues i shërbimeve, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në, para të gatshme, aksionë, pasuri të patundëshme, dhurata, udhëtime apo shërbime personale;
 - (b) pronësi në, apo autoritet për të ushtruar kontroll apo menaxhuar veprimtarinë e cilitdo furnizues të pajisjeve të telekomunikacionit apo ofruesi të shërbimeve, duke përfshirë PTK-në apo nënvarësve të saj ose cilit do pasues në interes.
- (3) Kufizimet e paragrafit (2) (b) nuk do të zbatohen për aksionët që investohen dhe që mbahen në formë të skemës së pensionëve apo fondit të ndërsjelltë të ndërmjetësuar, duke marrë parasysh sidoçoftë që vlera e aksionëve të tilla të mos kalojë 5 përqind të kapitalit të tregut, dhe duke marrë parasysh që aksionët e tilla të bëhen publike në formë të një deklarate zyrtare në kohën e vendosjes së tyre apo mbrenda 15 ditëve pas transakcionit të tillë.

Nëni 9

Vendosja dhe mbledhja e tarifave

- (1) ART-ja do të caktoj taksat administrative për shërbimet e telekomunikacionit në pajtim me këtë ligj dhe ligjislacione të tjera relevante . ART-i do të publikojë skemën e saj të tarifave në faqen e saj zyrtare në internet, dhe do ta vërë një kopje në dispozicion në zyrat e ART-it për inspektim nga publiku.
- (2) ART-i do të nxjerrë lista të tarifave siç vijon:
- (a) Jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ART-i do të zbatojë një listë të tarifave që do të vendosen për procesimin e aplikacionëve, regjistrimin, liçensimin, lëshimin e të drejtës për përdorimin e burimeve të caktuara të frekuencave, si dhe lëshimin e numrave dhe bllokave të numrave;
 - (b) Jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ART-i do të zbatojë një listë të tarifave që do të vendosen në lidhje me tenderët publik dhe ankandet.
 - (c) Jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ART-i do të zbatojë një listë të tarifave të cilat do të vendosen për kundravajtje, gjoba dhe dënime. Gjobat dhe dënimet do të përcaktohen në EURO dhe këtë do ta bëjë Ministria.
- (3) Lista e tarifave për secilën kategori të shërbimeve do të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë ofruesit e shërbimeve.
- (4) ART-i ka të drejtë që të ndryshojë listën e tarifave. Rritjet apo zvoglimet e tarifave do të zbatohen në mënyrë të njëjtë për secilën kategori aplikative. ART-i do të publikojë në faqen e saj zyrtare në internet të gjithëa ndryshimet e tilla të propozuara jo më vonë se 3 muaj para datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve të tilla.
- (5) ART-i do të caktojë rregulla të brendëshme për të siguruar që, pikëpamjet e publikut dhe sektorit privat të mirren në konsideratë, sa ka të bëjë me të gjithëa tarifat dhe rritjet e tarifave.

(6) ART-i do të caktojë dënime për pagimin e vonshëm të tarifave të përshkruara në këtë nën, dënime këto që do të jenë 25 përqind e tarifës që nuk është paguar me kohë.

Nëni 10 Seancat publike

(1) ART-i mund të organizojë seanca publike mbi të gjithëa çështjet e rëndësishme të telekomunikacionit, ose me vetëiniciativë ose pas kërkesës me shkrim nga Ministri.

(2) ART-i mund të organizojë seanca që kanë të bëjnë me autoritetin e saj rregullativ, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në, vendosjen e tarifave dhe shkeljeve të kornizës rregullative nga ofruesit e shërbimeve

(3) Seancat e mbajtura nga ART-i, do të jenë publike, përveç nëse ART-i vendos ndryshe, për shkak të trajtimit të ndonjë çështje me karakter konfidencial në nje seancë të tillë.

(4) ART-i do të adoptojë rregulla dhe procedura specifike për të qeverisur seancat publike. ART-i, do të vë në dispozicion të publikut procedurat e saj për organizimin e seancave.

(5) Të dhëna gjithëpërfshirëse me shkrim do të regjistrohen gjatë seancave të mbajtura nga ART-i.

Nëni 11 Ankesat, zgjidhja e konflikteve dhe e drejta për të apeluar

(1) Jo më vonë se 30 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ART-i do të adoptojë procedura për tu përgjegjur me efektshmëri komenteve apo ankesave nga palët e ndikuara, personat me interes legjitim dhe publikut në përgjithësi.

(2) Aty kur kërkohet në këtë ligj apo në legjislacionin tjetër përkatës, ART-i do të zgjidhë konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në aktivitetet e telekomunikacionit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në konfliktet ndërmjet ofruesve të shërbimeve, shfrytëzuesve dhe pronarëve të tokës dhe pajisjeve (ndërtesave).

(3) ART-i do ti fillojë procedurat e tilla për zgjidhjen e konflikteve, ose me kërkesën e njëres palë në konflikt sipas paragrafit (1) të këtij nëni, ose me vetëiniciativë.

(4) Me pranimin e një kërkesë nga një palë për të filluar procedurat për zgjidhjen e konflikteve, ART-i nuk do të ketë më shumë se 6 javë për të mbledhur informata me qëllim të marrjes së vendimit për pranimin apo refuzimin e një kërkesë të tillë.

(5) Në rast se ART-i e refuzon kërkesën për fillimin e procedurave për zgjidhjen e konflikteve, palët do të njoftohen me shkrim, së bashku me arsyet për një refuzim të tillë.

(6) Në rast se ART-i pranon kërkesën për të zgjidhur konfliktin, ART-i do të mbajë një mbledhje me palët konfliktuoze, do të mbajë një seancë të dëgjimit me qëllim të parashtrimit të të gjithëa fakteve përkatëse pastaj dhe të lëshojë vendimin, duke e pranuar ose refuzuar ankesën.

(7) Vendimet e ART-it do të bazohen në ligjin aplikativ apo rregulloret, gjithëmonë duke ndjekur principin e mbrojtjes së interesit të shfrytëzuesve, promovimit të risive dhe zhvillimit të sektorit të telekomunikacionit, dhe mbrojtjen e konkurrencës.

(8) Aktet dhe vendimet zyrtare të ART-it do të shqyrtohen nga gjyqet dhe do të jenë subjekt i çfarëdo apelimi nga palët e pakënaqura përmes procedurave administrative gjyqësore, siç përshkruhet në ligjin në Kosovë.

Nëni 12

E drejta për të mbledhur dhe mbajtur informata

(1) ART do të mbledhë dhe do të mbajë informata, duke përfshirë, mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në: statistika, financa, raporte të punësimit dhe raporte mbi veprimin e rrjetës, apo raporte të tjera të cilat i nëvojiten për të ushtruar përgjegjësitë e tij sipas këtij ligji apo çfarëdo legjislacioni tjetër përkatës.

(2) ART do të mbledhë të dhëna personale vetëm në pajtim me ligjin e Kosovës.

(3) Gjatë trajtimit të informatave të mbledhura ART-i do t'i ruaj fshehtësitë afariste dhe informatat e tjera konfidenciale.

Nëni 13

Shënimet zyrtare

(1) Në bazë të autoritetit të tij për të mbledhur dhe mbajtur informata, ART-i do të krijojë dhe mbajë regjistra zyrtarë të ofruesve të shërbimeve, personave që u janë akorduar radio frekuenca si dhe personave që u janë dhënë blloqe numrash sipas sistemit vendor të numërimit.

(2) Regjistrat zyrtarë do të administrohen sipas një baze (program) të ndërsjelltë kompjuterike të të dhënave.

(3) Të dhënat në vijim duhet të përfshihen nga ART-i në regjistrin e ofruesve të shërbimeve:

- (a) emri i plotë dhe titulli i ofruesit të shërbimeve;
- (b) statusi ligjor dhe numri i tatimpaguesit;
- (c) emri i plotë dhe numri identifikues personal i zyrtarit përgjegjës;
- (d) numri i regjistrimit në regjistrin afarist të Kosovës;
- (e) adresa apo adresa e zyrës kryesore;
- (f) informata lidhur me autorizimin dhe/apo licensën e lëshuar;
- (g) data e skadimit të afatit të autorizimit dhe/apo licensës së lëshuar;
- (h) lloji i shërbimeve të telekomunikacionit që do të ofrohen;
- (i) informata tjera relevante në autorizim dhe/apo licensë;
- (j) informata mbi klasifikimin e ofruesit të shërbimeve sa ka të bëjë me fuqinë e tij në treg; dhe,
- (k) informata që kanë të bëjnë me pagimin nga ofruesi i shërbimeve të tarifave, dënimeve dhe apo gjobave të vendosura nga ART-i.

(4) Të dhënat në vijim duhet të përfshihen nga ART-i në regjistrin e personave të cilëve u janë akorduar burime të spektrit frekuencor:

- (a) emri i plotë dhe titulli i personit;
- (b) statusi ligjor dhe numri i tatimpaguesit;
- (c) emri i plotë dhe numri personal identifikues i zyrtarit përgjegjës;
- (d) numri i regjistrimit në regjistrin afarist të Kosovës;
- (e) adresa apo adresa e zyrës kryesore;
- (f) informata lidhur me akordimin e radio frekuencës;
- (g) data e skadimit të afatit të licensës;
- (h) lloji i shërbimeve të telekomunikacionit që do të ofrohen;
- (i) informata tjera lidhur me caktimin e frekuencave personit përkatës; dhe,
- (j) informata lidhur me pagimin e tarifave, dënimeve apo gjobave të vendosura nga ART-i nga personi në fjalë.

(5) Të dhënat në vijim duhet të përfshihen në regjistrin zyrtar të personave të cilëve u janë dhënë blloqe të numrave sipas planit të Kosovës të numërimit:

- (a) emri i plotë dhe titulli i personit;
- (b) statusi ligjor dhe numri i tatimpaguesit;
- (c) emri i plotë dhe numri personal identifikues i zyrtarit përgjegjës;
- (d) numri i regjistrimit në regjistrin afarist të Kosovës;
- (e) adresa apo adresa e zyrës kryesore;
- (f) informata lidhur me dhënjen e blloqeve të numrave;
- (g) data e skadimit të afatit të licensës;
- (h) lloji i shërbimeve të telekomunikacionit që do të ofrohen;
- (i) informata tjera lidhur me caktimin e frekuencave personit përkatës; dhe,
- (j) informata lidhur me pagimin e tarifave, dënimeve nga personi në fjalë apo gjobave të vendosura nga ART-i.

(6) ART-i gjithëashtu mund të marrë informata të specifikuara në paragrafin 5 të këtij nëni përmes një lidhjeje direkte të kompjuterizuar.

(7) ART-i do të dorëzojë një raport vjetor në Kuvend, mbi punën e ART-it gjatë vitit paraprak. ART-i do të publikojë raportin në faqen e tij zyrtare në internet, si dhe do të vërë një kopje në dispozicion në zyrat e saj për inspektim nga publiku.

Nëni 14 Hetimet dhe kundravajtjet

(1) ART-i mund të hetojë çfarëdo fakte, kushte, veprimtari, apo çështje të cilat ai mendon se është e nevojshme të përcaktohet nëse ndonjë person ka shkelur apo do të shkelë këtë ligj, ligje tjera aplikative, apo çfarëdo vendimi të marrë në bazë të tyre, apo për të ushtruar çfarëdo përgjegjësie tjetër të ligjshme të ART-it.

(2) Gjatë ushtrimit të hetimeve të tilla, një anëtar i bordit të ART-it apo cilido zyrtar i caktuar nga bordi, do të ketë të drejtë që të ftojë dëshmitarë apo t'i detyrojë ata që të jenë të pranishëm, të marrë prova dhe të kërkojë prodhimin e librave, letrave, kontratave, marrëveshjeve dhe shënimeve të tjera të nevojshme për hetimin.

(3) Në rast se ndonjë person dështon që tu bindet urdhërave të ART-it, ART-i mund të kërkojë ndihmën e çfarëdo gjykatë me jurisdiksionin kompetent apo institucioni për zbatimin

e ligjit për të siguruar pajtueshmërinë e personave në fjalë me të.

(4) Një kompani, organizatë apo njësi tjetër ligjore do të jetë e detyruar nga ky ligj nëse ka vepruar, ka marrë një vendim apo ka dështuar që të veprojë ku është dashur të veprojë, si rezultat i një vendimi të marrë apo veprimi të kryer (çoftë me qëllim, me pamaturë apo me nëglizhencë) nga një drejtor, sekretar, menaxher, anëtar i bordit apo zyrtar tjetër i asaj kompanie, organizatë apo njësie.

Nëni 15

Zbatimi

(1) ART-i do të emërojë inspektorë për të verifikuar ekzekutimin ligjor të kushteve të licencës dhe që të deyrojnë shfrytëzimin ligjor të burimeve të spektrit frekuencor, duke përfshirë, mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) Ndërtimin e infrastrukturës së rrjetit;
- b) Përgjet, kanalet dhe lidhjet e brendëshme.

(2) ART-i do të lëshojë identifikime zyrtare për inspektorët dhe do t'u sigurojë udhëzime me shkrim për ushtrimin e inspektimit. Inspektorët mund të marrin mendime nga ekspertët si dhe këshilla teknike që do t'u ndihmojnë në misionin e tyre.

(3) Ofruesit e shërbimeve duhet të ofrojnë dokumente, planë dhe çasje në objekte sipas kërkesës së inspektorëve që kanë urdhëresa me shkrim për ushtrimin e inspektimit.

(4) ART-i mund të lëshojë urdhëra të shkruara për bllokimin dhe blombimin (plumbimin) e paisjeve dhe/apo objekteve që nuk kanë licencë, kur ajo ka skaduar apo kur inspektorët kanë dëshmi të dokumentuar që kushtet e licencës nuk janë përmbushur. Urdhërat e ART-it për bllokim do të implementohen nga inspektorët e tij dhe autoritetet e Kosovës për zbatimin e ligjit.

(5) Kur inspektorët kanë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se i licencuari ka bërë kundërvajtje ndaj këtij ligji, ndaj kushteve të licencës dhe/apo rregullave të miratuara, ART-i mund:

- a) të vendosë gjoba dhe lëshojë urdhëra me shkrim për të përmirësuar veprimet e gabueshme brenda një periudhe të caktuar kohore;
- b) suspendojë apo revokojë autorizimet e përgjithëshme apo licencën individuale.

Nëni 16

Masat për barrierat e hyrjes në treg

(1) Jo më vonë se 9 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ART-i duhet t'i dorëzojë Kuvendit një raport në të cilin identifikohen dhe lehtësohen lëvizjet e barrierave për hyrje në treg për sipërmarrësit dhe bizneset e tjera të vogla për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit.

(2) Raporti duhet të marrë parasysh mendimet dhe brengat e sektorit privat, që do të mund të kërkohen ose përmes një procedure formale publike, në formë të një kërkesë me shkrim për dorëzimin e komenteve, ose që të dyjat. Në veçanti, ky shqyrtim do të përqëndrohet në çështjet në vijim:

- a) mundësinë, kualitetin dhe çmimet e lidhjeve të huazuara, ndërlidhjeve, duke përfshirë elementete e pa-ndërlidhura të rrjetës dhe informatat themelore të parapaguesit që janë të përshtatëshme për regjistrat telefonik dhe faqet e verdha;
 - b) sigurimin e mallrave dhe shërbimeve nga PTK-ja, bazuar në konkurrencë.
 - c) barrierat për adoptimin e tregtimit elektronik, duke përfshirë këtu, mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në:
 - (i). nënshkrimet elektronike;
 - (ii). infrastrukturën kyçe publike
 - (iii). emërimin dhe adresimin në internet.
 - (iv). aspektin teknik dhe financiar të portave ndërkombëtare, që sigurojnë ndërlidhjen dhe orientimin e trafikut telefonik brenda dhe jashtë Kosovës.
- (3) ART-i do të ndërmarrë një shqyrtim të ri të atyre lëndëve të përmendura në paragrafin (2) të këtij nëni dhe t'i raportojë Kuvendit jo më vonë se 1 vit pas shqyrtimit të parë, dhe pastaj do të bëjë këtë raportim në baza vjetore.

Nëni 17 Përputhshmëria me BE-në

(1) Jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ART-i duhet t'i dorëzojë Kuvendit një raport në të cilin identifikohen pengesat teknike që të mund të arrihet përputhshmëri e plotë me udhëzimet dhe vendimet e BE-së sa ka të bëjë me zhvillimin e një tregu të hapur dhe konkurrues të telekomunikacionit. Ky shqyrtim do të përqëndrohet veçanërisht në çështjet teknike në vijim:

- (a) radio frekuencat;
 - (b) plani i numërimit: adoptimi i përgjegjësive të numërimit të kornizës së ONP, veçanërisht të numrit të zakonshëm hyrës ndërkombëtar (00) dhe numrat pa tarifë (emergjenca dhe shërbimet tjera me vlerë të shtuar të rrjetës);
 - (c) tregëtimi elektronik: adoptimi i Udhëzimit të BE-së për themelimin e një kornize të përbashkët për nënshkrimet elektronike dhe rrjedhjen ndërkufitare të informatave;
 - (d) emërimi dhe adresimi në internet: krijimi i një sfere (domaini) të nivelit më të lartë me qëllim të lehtësimit të shfrytëzimit afarist të internetit në Kosovë; dhe,
 - (e) lidhjet me ofruesit ndërkombëtar të shërbimeve: adoptimi i procedurave publike dhe dokumenteve të referencës
- (2) ART-i do të bëjë një rishqyrtim të ri të lëndëve të cekura në paragrafin 1 të këtij nëni dhe t'i raportojë Kuvendit jo më vonë se 1 vit pas shqyrtimit të parë, dhe pas asaj do të raportojë në baza vjetore.

Kapitulli 4 **PTK**

Neni 18

PTK është operator publik i shërbimeve potale dhe telekomunikuese në Kosovë siç është definuar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/12.

Neni 19

MTPT, nëpërmes Bordit Mbikqyrës do të mbikqyrë punën e PTK-së.

Kapitulli 5 **Autorizimet dhe Liçencat**

Nëni 20

Autoriteti i ART-it

- (1) Përveç nëse është përcaktuar saktësishtë ndryshe në këtë ligj, ART-i do të ketë pushtetin e vetëm për të lëshuar autorizime dhe liçensa për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë.
- (2) ART-i do t'i ushtrojë të gjithëa aktivitetet dhe veprimtaritë në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.

Nëni 21

Autorizimet

- (1) Asnjë person nuk mund t'i ofroj publikut shërbime të telekomunikacionit në Kosovë pa siguruar autorizimin e ART-it për ofrimin e shërbimeve të tilla.
- (2) Ofruesit e shërbimeve që krijojnë shërbime të telekomunikacionit për nëvojat e tyre ekskluzive nuk kanë nevojë për autorizim, mirëpo mund të kërkohet nga ta që të marrin një liçensë, në rast se ata dëshirojnë të shfrytëzojnë resurse të kufizuara.
- (3) ART-i do të parashkruaj procedura të sakta jo-diskriminuese dhe me shkrim për zbatimin, procesimin dhe lëshimin e autorizimeve.
- (4) Si pjesë e procesit të autorizimit, ART-i është i autorizuar që të kërkojë informata të tilla nga aplikanti, informata këto që me arësye kërkohen për të verifikuar të dhënat e dokumentuara dhe përputhshmërinë e aplikantit me dispozitat e këtij ligji.
- (5) Autorizimet do të lëshohen në pajtueshmëri me dispozitat e këtij ligji që gjinden në kushtet e përgjithëshme, të cilat do të përfshijnë, në minimum, pajtueshmërinë e aplikantit për t'u/të:
 - a) ofruar shërbime publikut në baza transparente dhe jo-diskriminuese;
 - b) ofruar shfrytëzuesve një kontratë standarde dhe jo-diskriminuese me shkrim, që sipas kërkesës, duhet t'i tregohet ART-it;

- c) zbatuar sisteme të cilat do të sigurojnë që të gjithë parapaguesit të marrin fatura të sakta dhe të detaizuara;
 - d) ofruar të gjithë shfrytëzuesve një procedurë për zgjidhjen e konflikteve; dhe
 - e) publikojë dhe sigurojë një njoftim të duhur publik për ndryshime në kushtet e qasjes, duke përfshirë tarifën, kualitetin dhe dispozicionin e shërbimit.
- (6) ART-i mund të vendosë kushte plotësuese për autorizime, duke u bazuar në katëgorinë e shërbimeve, të cilat mund të përfshijnë, mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në vijueset:
- (a) informatat e konsumatorëve, të nevojshme për dhënjen e një adresari të përgjithshëm të informatave;
 - (b) ofrimi i shërbimeve emergjente;
 - (c) aranzhmanët speciale për personat e hendikepuar;
 - (d) kushtet e nevojshme për ndërlidhje të rrjetave;
 - (e) kushtet të cilat pasqyrojnë standardet e moralit publik të cilat mbrojnë sigurinë publike dhe,
 - (f) ofruesit e shërbimeve duhet të zhvillojnë një plan për ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve themelore të telekomunikacionit publikut edhe në rast të ndonjë greve apo aksioni punues, të cilën, nëse aprovohet nga ART, ata do të implementojnë pas njoftimit me shkrim nga Ministria.
- (7) ART-i do të caktojë llojet apo katëgoritë aplikative të shërbimeve të cilat kanë nevojë për Autorizime, të cilat mund të përfshijnë, mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në:
- (a) shërbimet me të dhëna, duke përfshirë shërbimet e të dhënave me paketa fikse apo shërbime të të dhënave nëpërmjet komutimeve që i ofrohen publikut;
 - (b) shërbimet e transmetimit me vlerë të shtuar, duke përfshirë multimediat, internetin dhe postën elektronike;
 - (c) shërbimet e transmetimit me zë në vlerë të shtuar, siç janë ato ruaj-dhe-dërgo si dhe shërbimet e postës së zërit, shërbimet e audiotekstit dhe teletekstit, video-konferencave, ri-dërgimi i porosive, videofonët;
 - (d) shërbimet me tarifë të lartë, siç janë shpenzimet e përbashkëta/ndara, të ardhurat e përbashkëta/ndara apo telefoni pa pagesë (freephonë) dhe kartelat telefonike për thirrje;
 - (e) shërbimet personale satelitore për komunikim.

Nëni 22

Liçensat

- (1) Asnjë person nuk mund të ofrojë shërbime të telekomunikacionit që përfshijnë një burim të kufizuar, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në të drejtën e përdorimit të një numri të akordimeve frekuencore, hapësirë në një shtyllë, piring apo kanal, pa siguruar autorizimin e ART-it, për ofrimin e shërbimeve të tilla.
- (2) Numri i liçensave që ART-i mund ti lëshojë është i pakufizuar, përveç kufizimeve teknike që kanë të bëjnë me përdorimin efektiv të spektrit të radio frekuencave, siç është saktësuar në planin mbi burimet e spektrit frekuencor dhe me miratimin e PSSP-së. Në rast të radio frekuencave të kufizuara, sipas vlerësimit të ART-it, ART-i do ti zgjedhë të liçensuarit me anë të një tenderi apo ankandi sipas këtij ligji.
- (3) ART-i do të parashkruaj procedura të sakta, jo-diskriminuese dhe me shkrim mbi procesin e kërkimit, procesimit dhe lëshimit të liçensave.
- (4) Liçensa do t'i lëshohet një aplikanti që, sipas gjykimit të ART-it posedon burime financiare të mjaftueshme si dhe mundësi teknike për të përmbushur kushtet e liçensës.
- (5) Nëse ART-i zbulon se me lëshimin e një licence do të ngriten çështje të sigurisë së Kosovës apo rendit publik, atëherë ai do t'ja referoj çështjen Ministrisë për ta zgjidhur.
- (6) Si pjesë e procesit të liçensimit ART-i është i autorizuar të kërkojë informata të tilla nga aplikanti, informata këto që në masë të arësyeshme janë të nevojshme për të verifikuar informatat e dokumentuara dhe pajtueshmërinë e aplikantit me dispozitat e këtij ligji;
- (7) Liçensat do të jepen në pajtueshmëri me dispozitat që gjenden në kushtet e përgjithëshme të liçensave, të cilat në minimum do të përfshijnë:
 - (a) llojin, karakteristikat, hapësirën e mbulimit me shërbim si dhe orarin e zgjatjes/zgjerimit të rrjetës;
 - (b) orarin e veprimit, kualitetin dhe mundësinë e qasjes në rrjet si dhe kushtet e qasjes, veçanërisht për telefonët publikë me pagesë apo ekuivalentët e tyre në rast të shërbimeve mobile;
 - (c) kushtet e konfidencialitetit dhe neutralitetit të shërbimeve lidhur me informatat e transmetuara;
 - (d) standardet dhe specifikimet për rrjeta dhe shërbime, e veçanërisht, ku është e mundshme, standardet europianë;
 - (e) kushtet e nevojshme për mbrojtjen e ambientit dhe për piksynimet e planifikimit komunal, duke përfshirë, aty ku është e mundshme, kushtet që qeverisin shfrytëzimin e sferës (domanit) dhe bashkëshfrytëzimin e hapësirës dhe mjeteve;
 - (f) kushtet e nevojshme në interes të mbrojtjes të Kosovës dhe shërbimet emergjente si, zjarrfiksit, policia dhe ambulanca;
 - (g) kontributi i ofruesit të shërbimeve me hulumtime dhe trajnim në lëminë e telekomunikacionit;
 - (h) shfrytëzimi i spektrit të radios, tarifatat lidhur me një përdorim të tillë si dhe shpenzimet e menaxhimit dhe monitorimit të spektrit;
 - (i) akordimi i numrave individual apo renditjes së numrave, tarifatat lidhur me menaxhimin dhe monitorimin e planit të numërimit;

- (j) obligimet e shërbimeve universale me të cilat është i ngarkuar mbajtësi i licensës në pajtim me kapitullin 6 të këtij ligji;
- (k) dhënja e informatave të nevojshme për themelimin e adresarit të parapaguesve sipas këtij ligji;
- (l) të drejtat dhe obligimet e ofruesit të shërbimeve që kanë të bëjnë me ndërlikohen;
- (m) kushtet e nevojshme për promovimin e konkurrencës së drejtë;
- (n) kushtet e nevojshme për të siguruar trajtimin e barabartë të ofruesve ndërkombëtarë të shërbimeve;
- (o) kushtet e nevojshme për sigurimin e operimit të ndërsjellë të shërbimeve të ndryshme;
- (p) obligimet me të cilat është i ngarkuar ofruesi i shërbimeve që të lejojë ART-in t'i bëjë të detyrueshme kushtet e përgjithëshme të ofruesit të shërbimeve;
- (q) tarifrat që paguhen për lëshimin, menaxhimin dhe kontrollimin e licensave; si dhe;
- (r) trajtimi i barabartë dhe dhënja e informatave parapaguesve, veçanërisht informatave që kanë të bëjnë me kushtet e kontratës në pajtim me të cilat ofrohet shërbimi, dhe e cila i ofron kompensim parapaguesit në rast se ofruesi i shërbimeve nuk përmbush kërkesat mbi kualitetin e shërbimeve të saktësuara në paragrafin (b) të këtij nëni.

Nëni 23

Dorëzimi, miratimi dhe publikimi i kushteve të përgjithëshme dhe çmimeve

- (1) Ofruesit actual të shërbimeve dhe ata që kërkojnë të ofrojnë shërbime të telekomunikacionit për të cilat nëvojitet licensa sipas këtij ligji, duhet të pregatisin dhe t'i dorëzojnë ART-it një përshkrim të shërbimeve dhe të kushteve të përgjithëshme, në të cilat përshkruhen në mënyrë të detajuar çmimet për shërbime të tilla.
- (2) Para implementimit të kushteve të përgjithëshme, ofruesit e shërbimeve me fuqi të konsiderueshme në treg duhet të dorëzojnë një mostër të kontratës për parapaguesit e cila do t'i bashkangjitet kushteve të përgjithëshme dhe duhet të marrin miratimin me shkrim për të nga ART-i.
- (3) ART-i duhet të lëshojë një miratim me shkrim për kushtet e përgjithëshme dhe çmimet jo më vonë se 7 ditë pas pranimit nga ofruesi i shërbimeve përveç nëse ART-i vlerëson që i nevojiten informata plotësuese dhe/apo kalkulime shtesë, me ç'rast pas njoftimit të ofruesit të shërbimeve lidhur me këte, kjo periudhë kohore do të zgjatët për jo më shumë se 14 ditë.
- (4) Në rast se ART-i dështon që të nxjerrë pajtimin e tij me shkrim ndaj ofruesit të shërbimeve brenda periudhës së specifikuar në paragrafin 3 të këtij nëni, atëherë do të supozohet se ART-i ka dhënë pajtimin e vet.
- (5) ART-i mund të urdhërojë një ofrues të shërbimeve që të bëjë ndryshime në kushtet e tij të përgjithëshme edhe pasi të jetë dhënë pajtimi i ART-it, në rast se ai vlerëson se ndryshimet e tilla janë të nevojshme që të mbrohen parapaguesit, apo të mbrohet konkurrenca.

Nëni 24
Formulimi i çmimeve

- (1) Çmimet e shërbimeve të telekomunikacionit do të bazohen në çmimin e ofrimit efikas të shërbimeve të tilla, dhe, për llojin e njëjtë të shërbimit nga ofruesi i njëjtë i shërbimeve, ai duhet të jetë identik nëpër tërë Kosovën, apo në tërë hapësirën e veprimit të ofruesit të shërbimeve në rast se ofruesi i shërbimeve nuk vepron në tërë territorin e Kosovës.
- (2) Çmimet për shërbimet e rrjetës së telefonisë fikse dhe për shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve me fuqi të konsiderueshme në treg do të përbëhen nga çmimet aktuale të ofrimit të shërbimeve të tilla, duke u bazuar në standardet e aplikueshme të kontabilitetit.
- (3) Çmimet për shërbimet e rrjetës së telefonisë fikse dhe për shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve me fuqi të konsiderueshme në treg duhet të jenë:
- (a) të klasifikuara në masë të mjaftueshme që t'u lejojnë konsumatorëve që mos të paguajnë për shërbimet që nuk i përdorin;
 - (b) transparente, jo-diskriminuese dhe të pandryshuara nga aplikimi i parapaguesit;
 - (c) të jenë në dispozicion për shqyrtim nga publiku;
 - (d) të jenë të disajnuara në atë mënyrë që lirimet të jenë të përshtatura që të sigurohet që shërbimet apo prodhimet e lidhura të mos ndikojnë në mënyrë të dis-favorshme në konkurrencë.
- (4) Ofruesit e shërbimeve mund t'i reduktojnë çmimet e furnizimit të aplikimeve të përgjithëshme siç është e cekur në këtë nën, në mënyrë që të marrë në konsideratë rrethanat e veçanta të personave me paaftësi apo katëgorive të tjera të konsumatorëve.
- (5) Në pajtim me kushtet e këtij nëni, ART-i do të zhvillojë dhe implementojë një politikë të detajuar të vendosjes së çmimeve e cila do të jetë në përputhshmëri me kërkesat e këtij ligji.

Nëni 25
Përmbajtja e liçencës

- (1) Një liçensë duhet të përmbajë, por nuk do të kufizohet vetëm në:
- (a) informatat që kanë të bëjnë me llojin e shërbimeve, karakteristikat dhe/apo standardet e veprimit të rrjetës, hapsira të cilën ajo mbulon, si dhe informatat lidhur me kapacitetet dhe zgjerimin e rrjetës;
 - (b) informatat që kanë të bëjnë me të liçensuarin dhe të gjithë kufizimet tjera aplikative;
 - (c) kushtet e liçensës; dhe
 - (d) obligimet e të liçensuarit sipas këtij ligji dhe të gjithë legjislacionëve tjera që janë në përputhshmëri me këtë ligj.

Nëni 26

Kushtet, transferi, ndryshimi, përtëritja, anulimi, revokimi dhe skadimi

- (1) Çdo licënsë do të lëshohet për një periudhë të caktuar kohore që nuk duhet të kalojë 15 vite, dhe që duhet të paguhet në baza vjetore.
- (2) Si kusht për vazhdimin e vlefshmërisë së cilësdo licënsë të lëshuar, i licënsuari do të raportojë në ART çfarëdo ndryshimi në statusin e tij ligjor, civil apo tatimor, apo fillimin e çfarëdo procedure ligjore apo procedure të falimentimit, vullnëtarisht apo jo-vullnëtarisht, kundrejt të licënsuarit brenda 30 ditëve
- (3) Asnjë licënsë nuk mund ti transferohet asnjë personi, duke përfshirë edhe transferimet në bazë të një procesit të likuidimit të urdhëruar nga gjykata, pa miratimin paraprak të ART-it.
- (4) ART mund të ndryshojë një licënsë nëse:
 - (a) është udhëzuar nga Ministria në koordinim të ngushtë me PSSP-në si çështje e menaxhimit të spektrit të radio frekuencave; apo
 - (b) kërkohet sipas dekreteve ndërkombëtare ligjore që janë valide në Kosovë.
- (5) Në fund të periudhës për të cilën është lëshuar licënsa, ART-i mundet, por nuk do të jetë i obliguar që të ripërtijë edhe nëse të gjithë kushtet e parashkuara për marrjen e një licënsë janë përmbushur.
- (6) ART do të anulojë licënsën nëse kërkohet nga i licënsuari.
- (7) ART duhet të revokojë licënsën nëse:
 - (a) i licënsuari dështon që të përmbushë kushtet e licënsës sipas ART-it;
 - (b) aplikacioni për licënsë zbulohet se përmban informata të rrejshme, të pasakta apo informata të rrejshme që kanë karakter të rëndësishëm;
 - (c) i licënsuari dështon të fillojë ofrimin e shërbimeve brenda një viti nga lëshimi i saj, përveç nëse nuk është e cekur ndryshe në licënsë;
 - (d) tarifa për licënsë nuk është paguar dhe paralajmërimi me shkrim për mospagesë është dorëzuar më parë;
 - (e) në bazë të udhëzimeve nga Ministria në koordinim të ngushtë me PSSP-në si çështje e menaxhimit të spektrit të radio frekuencave dhe/apo;
 - (f) nëse ART-i përcakton se dështimi i ofruesit të shërbimeve për të kryer obligimet e tij sipas licënsës do të shkakëtonte parregullsi të mëdha në treg.
- (8) Një licënsë do të skadojë:
 - (a) me përfundimin e periudhës kohore për të cilën është lëshuar, nëse nuk ripërtijet, apo;
 - (b) nëse i licënsuari pushon së ekzistuari dhe transferimi nuk është bërë;
- (9) Të gjithë veprimet e ndërmarra nga ART-i në bazë të këtij nëni do të bëhen publike dhe do të vendosen në faqen zyrtare të ART-it në internet.

Nëni 27

Përdorimi i përbashkët i pajisjeve dhe e drejta për të kaluar

ART-i do të vendosë rregulla për përdorimin e pronave nën kontrollin privat dhe publik sa ka të bëjë me shërbimet e telekomunikacionit dhe ofruesit e shërbimeve, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në shtyllat e transmetimit për shërbimet ajrore, ngjitjen e shtyllave telefonike për shërbimet me kablo dhe format tjera aplikative infrasrukturale. ART-i gjithëashtu do të vendosë rregulla për të minimizuar shkatërrimin aksidental apo dëmtimin e pajisjeve të rrjetës, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në kabllot për transmetim ajror apo kablovik.

Kapitulli 6

Akordimi i të drejtës për përdorimin e radio frekuencave

Nëni 28

Frekuencat që janë subjekt i licensave

- (1) Spektret e radio frekuencave të cilat janë akorduar për nevojat e mbrojtjes të Kosovës si dhe emergjencës, apo për mbrojtjen nga fatëkeqësitë natyrore apo fatëkeqsi të tjera janë pushtet i rezervuara për PSSP-në. Në bazë të kësaj ART-i nuk do të ketë autoritet që të akordojë të drejtën për përdorimin e spektrit frekuencor të rezervuar për PSSP-në.
- (2) Ofruesit e shërbimeve që dëshirojnë të përdorin frekuencat që i janë akorduar IPVQ-së nga PSSP-ja, do të marrin të drejtën për përdorimin e frekuencave të tilla nga ART-i para fillimit të ofrimit të shërbimeve. ART-i do të akordojë të drejtën për përdorimin e radio frekuencave sipas këtij ligji dhe legjislacionëve tjera përkatëse.
- (4) ART-i do të parashkruajë radio frekuencat për të cilat nuk do të ketë nevojë të mirret e drejta për përdorim nga ART-i dhe do ti vërë këto informata në dispozicion të publikut.

Nëni 29

Procesi i aplikimit dhe standardet

- (1) ART-i do të përcaktoj kushte e procedura precise jo-diskriminuese me shkrim për procedurat e kërkimit, procesimit dhe akordimit të së drejtës për përdorimin e radio frekuencave.
- (2) ART-i do të rrefuzojë akordimin e të drejtës për shfrytëzim të radio frekuencave në rast që përcakton se:
 - (a) kërkesa e aplikantit nuk është teknikisht e arritshme;
 - (b) akordimi i të drejtës do të ishte në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
 - (c) akordimi i të drejtës për shfrytëzim të radio frekuencave nuk do të lejonte shfrytëzimin efektiv të spektrit të radio frekuencave apo të veprimit/punës së paisjeve tjera të telekomunikacionit;
 - (d) aplikanti ka thyer kushtet e këtij ligji apo nuk ka përmbushur obligimin për pagimin e tarifave për shfrytëzimin e radio frekuencave;
 - (e) nëse me akordimin e të drejtave për shfrytëzimin e radio frekuencave, një

sinjal nga paisja e radios do të shkaktonte pengesa të papranueshme në radio pajisjet e tjera, në pranuesit e tjerë apo sistemet elektrike apo elektronike.

Nëni 30

Kërkesat për publikim

(1) Pas pranimit të ndonjë aplikacioni për shfrytëzimin e radio frekuencës apo radio frekuencave për ofrimin e shërbimeve publike të telekomunikacionit në Kosovë, ART-i duhet të publikojë informata në të cilat deklarohet pranimi i një aplikacioni dhe qëllimin për të cilin aplikanti do të përdorë frekuencën, mirëpo nuk do të publikojë informata lidhur me aplikantin. Publikimi gjithëshe duhet të ftojë aplikantët e tjerë që të dorëzojnë aplikacionë për atë frekuencë jo më vonë se 60 ditë pas datës së publikimit.

(2) Nëse gjatë periudhës 60 ditëshe të përshkruar në paragrafin (1) të këtij nëni, ART-i nuk pranon aplikacionë të tjera, apo nëse ART-i pranon aplikacionë të tjera dhe është e mundshme për ART-in që të bëjë akordimin e radio frekuencave të gjithë aplikantëve njëkohësisht, ART-i do të akordojë të drejtën për shfrytëzim të frekuencës së specifikuar në pajtim me kushtet e këtij ligji.

(4) Nëse gjatë periudhës prej 60 ditësh të përshkruar në paragrafin (1) të këtij nëni, ART-i pranon një apo më shumë aplikacionë apo aplikantë plotësues dhe radio frekuencat nuk mund t'u ndahen të gjithë aplikantëve njëkohësisht, ART-i duhet t'i refuzojë të gjithë aplikantët dhe të shpallë një tender publik për akordimin e të drejtave për shfrytëzimin e radio frekuencave jo më vonë se 30 ditë pas datës së aplikimit të parë (origjinal), dhe do të akordojë të drejtën për shfrytëzim të radio frekuencës sipas procedurës të specifikuar nga ART-i që kanë të bëjnë me tenderin publik dhe ankandin.

Nëni 31

Përmbajtja e dokumentit për akordimin e të drejtës për shfrytëzimin e radio frekuencave

Dokumenti për akordimin e të drejtës për shfrytëzim e një apo më shumë radiofrekuencave do të përbëhet pos *tjerash*, nga komponentet në vijim:

- (a) Informatat që kanë të bëjnë me pranuesin e të drejtës;
- (b) Informatat që kanë të bëjnë me radio frekuencat e akorduara;
- (c) Informatat e lidhura me fushën e mbulimit të akorduar;
- (d) Informatat lidhur me periudhën e vlefshmërisë së të drejtës së akorduar; apo
- (e) Çfarëdo informata shtesë apo kushte plotësuese që kërkohen nga ART-i.

Nëni 32

Kohëzgjatja, zgjatja e afatit dhe skadimi

(1) Akordimi i të drejtës për përdorimin e radio frekuencave do të lëshohet nga ART-i për një periudhë të caktuar e cila nuk mund të kalojë 15 vite, e cila do të jetë subjekt i pagimit të një tarife vjetore si dhe çertifikatën e pajtueshmërisë me kushtet e përgjithëshme të së drejtës.

(2) Me kërkesën e pranuesit të së drejtës për përdorimin e radio frekuencave, ART-i do zgjasë periudhën kohore, si dhe të gjithë kushtet e mëparëshme do të vazhdojnë të jenë të

vlefëshme. Aplikacionët për zgjatjen e së drejtës për përdorimin e radio frekuencave do të dokumentohet në ART jo më vonë se 30 ditë para sakdimit të së drejtës.

- (3) E drejta për përdorimin e radio frekuencave do të skadojë:
 - (a) në fund të periudhës kohore për të cilën është akorduar e drejta për përdorim, përveç nëse ripërtrihet;
 - (b) nëse pranuesi i së drejtës pushon së ekzistuari;
 - (c) nëse pranuesi i së drejtës dështon që të fillojë përdorimin e radio frekuencave jo më vonë se 1 vit pas pranimit të së drejtës;
 - (d) me revokimin e së drejtës për përdorimin e radio frekuencave sipas dispozitave të këtij ligji
- (4) Veprimet e ndërmarrura nga ART-i që kanë të bëjnë me zgjatjen dhe skadimin do të bëhen publike.
- (5) Si kusht për vazhdimin e vlefshmërisë së çfarëdo të drejte për përdorimin e radio frekuencave, pranuesi do të raportojë në ART çfarëdo ndryshime në statusin e tij ligjor, civil apo tatimor, apo fillimin e çfarëdo procedure të falimentimit apo procedure ligjore, vullnëtarisht apo jo-vullnëtarisht, kundrejt pranuesit jo më vonë se 30 ditë.

Nëni 33

Radio frekuencat për sigurimin e shërbimeve publike radio mobile

- (1) ART-i mund të përfshijë një të drejtë për përdorimin e radio frekuencave në licensë për sigurimin e shërbimeve publike radio mobile, në pajtim me politikat e caktuara nga Ministria.
- (2) Në rast se një e drejtë për përdorimin e radio frekuencave përfshihet në licensë për sigurimin e shërbimeve, të gjithëa kushtet tjera që i përkasin transferimit, ndryshimit, revokimit dhe skadimit sipas këtij kapitulli do të jenë aplikative.

Nëni 34

Transferi, ndryshimi apo revokimi

- (1) Pranuesit e të drejtës për shfrytëzim të radio frekuencave mund t'i transferojnë ato të drejta personave të tjerë juridik apo fizik, me kusht që kushtet e përshkruara në të drejtën fillestare të akorduar të përmbushen më tutje dhe gjithëashtu që ART-i të japë pëlqimin me shkrim për atë transferim.
- (2) ART mund të ndryshojë të drejtën e akorduar për shfrytëzimin e radio frekuencave nëse:
 - (a) ndarja e spektreve të radio frekuencave ka ndryshuar apo janë paraqitur nëvojat urgjente publike të cilat nuk mundin të përmbushen në mënyra tjera;
 - (b) akordimi i tillë është i nevojshëm për shkak të shfrytëzimit më efikas të spektrit të radio frekuencave dhe për të mirën publike;

- (c) nuk është e mundëshme që në mënyra të tjera t'i shmanget radio pengesave të dëmshme;
 - (d) një akordim i tillë kërkohet nga dekretet ligjore ndërkombëtare të cilat Kosova është e detyruar ti zbatojë.
- (3) Në rastet e cekura në paragrafin (2) të këtij nëni, ART-i duhet të lëshojë të drejtën e re për shfrytëzimin e radio frekuencave.
- (4) Në rastet e specifikuar në paragrafin (2) të këtij nëni, ART mund të bëjë revokimin e të drejtës së akorduar për shfrytëzimin e radio frekuencave.
- (5) Në ato raste ku ART-i ka bërë ndryshime apo ka revokuar të drejtën e akorduar për shfrytëzimin e radio frekuencave, pranuesit e së drejtës mund të aplikojnë për frekuenca ekuivalente, vetëm nëse ndryshimet apo revokimi nuk kanë qenë për fajin e tyre. Në rast se nuk është e mundëshme që t'i lëshohet e drejta për shfrytëzimin e frekuencave ekuivalente, marrësi i të drejtës ka të drejtë të kërkojë kompensim për këtë.
- (6) ART duhet të revokojë të drejtën e akorduar për shfrytëzimin e radio frekuencave me kërkesën e mbajtësit të së drejtës, me kusht që mbajtësi i së drejtës të ketë përmbushur obligimet e së drejtës së akorduar dhe të gjitha obligimet e tjera përkatëse ligjore.
- (7) ART duhet të revokojë një të drejtë të akorduar për shfrytëzimin e radio frekuencave nëse përcakton që:
- (a) aplikacioni për të drejtën për shfrytëzim të radio frekuencave përmbante informata të rrejshme, mashtruese apo të pasakta;
 - (b) mbajtësi i së drejtës nuk përmbushë më kushtet e të drejtës së akorduar;
 - (c) tarifa për shfrytëzimin e radio frekuencave nuk është paguar dhe paralajmërimet për mospagesë janë dorëzuar; apo
 - (d) nëse sinjali prej radio paisjes shkakton ndërhyrje (pengesa) të papranueshme ndaj radio paisjeve të tjera, pranuesve apo sistemeve elektrike apo elektronike.
- (8) Veprimet e ndërmarra nga ART-i sa ka të bëjë me transferimet, ndryshimet dhe revokimet do të vihen në dispozicion të publikut.

Nëni 35

Tarifa dhe pagesa për marrjen e së drejtës

- (1) Një tarifë vjetore do të paguhet nga pranuesi në ART për të drejtën për përdorimin e radio frekuencave.
- (2) Një tarifë nuk do të kërkohet për të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencave që kanë të bëjnë me sigurinë e Kosovës dhe mbrojtjen ndaj fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive tjera si dhe për përdoruesit amatorë të radiove sipas këtij ligji.
- (3) ART do të përcaktojë në këtë nën tarifën që do të vendoset duke marrë parasyshë në mes tjerash:
- (a) hapësirën e shtrirjes;
 - (b) dendësinë e popullatës në hapësirën e shtrirjes;
 - (c) radio frekuencat apo gjerësinë e spektrit të radio frekuencave; apo

- (d) llojin e radiokomunikimeve që do t'i mbulojë e drejta e akorduar.

Nëni 36

Tenderi shtesë për shërbime mobile

Përkundër kushteve të tjera të këtij nëni, ART në koordinim të ngushtë me PSSP-në do të lëshojë të drejtën për shfrytëzim të radio frekuencës për GSM radio shërbimet mobile publike për transmetim në pajtim me procedurat që i përkasin tenderit publik dhe auksionit. Ministria do të pregatisë dokumentat e tenderit ndërsa ART-i do të implementojë tenderin. Jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ART-i do t'i ofrojë licensë çfarëdo ofruesi të shërbimeve mobile i cili për momentin nuk është duke ofruar shërbime mobile në tregun e Kosovës, përmes të ndonjë tenderi konkurrues ndërkombëtarë, në pajtim me këtë ligj dhe ligjet e tjera aplikative.

Kapitulli 7

Caktimi i numrave

Nëni 37

Caktimi i numrave

- (1) ART-i do të pregatisë një plan të numërimit, të caktojë numra dhe blloqe numrash dhe ti administrojë ato në mënyrë jo-diskriminuese siç është përshkruar në nënin 66 të këtij ligji.
- (2) Asnjë ofrues i shërbimeve nuk do të përdorë një numër apo numra përveç nëse dhe derisa ART-i ti caktojë numrat e tillë.
- (3) ART-i do të përcaktojë procedura të sakta jo-diskriminuese dhe me shkrim për kërkimin, procesimin dhe caktimin e numrave.
- (4) ART-i do të caktojë numra dhe blloqe numrash sipas këtij ligji dhe legjislacionëve tjera përkatëse.
- (5) Aplikacionët për caktimin e numrave do të përmbajnë fakte mbi përmbushjen e kushteve të specifikuara nga aplikanti, një projektim të nevojave për 3 vitet pasuese dhe arsyetimin i cili provon se sasia e numrave të ndarë janë përdorur gjatë periudhës 3 vjeqare.
- (6) Ofruesi i shërbimeve mund t'u akordojë numrat të cilat i janë akorduar, parapaguesve të tij të cilët do të jenë përdoruesit e fundit të numrave.
- (7) ART-i gjithëashtu do të publikojë procedurat në pajtim me të cilat mund të jepen numrat.
- (8) ART-i do ti vërë në dispozicion të publikut të gjithëa të dhënat që kanë të bëjnë me caktimin (akordimin), revokimin dhe skadimin e numrave.

Nëni 38
Kohëzgjatja, ndryshimi, vlefshmëria, revokimi dhe skadimi

- (1) Caktimi i numrave nga ART-i do të jetë për një periudhë të pacaktuar kohore.
- (2) ART-i nëse e konsideron të arësyeshme, mund të ndryshojë caktimin (akordimin) e numrave.
- (3) Caktimi i numrave do të zhvleftësohet nëse pranuesi i shkel kushtet e caktimit ose nëse pranuesi dështon që të fiksojë tarifat sa ka të bëjë me përdorimin e numrave të ndarë.
- (4) Si kusht për vlefshmërinë e vazhdueshme të çfarëdo numrash të ndarë, pranuesi do të raportojë tek ART-i çfarëdo ndryshimesh që kanë të bëjnë me satusin e tij ligjor, civil apo tatimor, apo fillimin e çfarëdo procedure të falimentimit apo procedure ligjore, vullnëtarisht apo jo-vullnëtarisht ndaj pranuesit jo më vonë se 30 ditë pasi që ndryshimet e tilla të jenë bërë efektive.
- (5) ART-i do të revokojë një caktim të numrave nëse përcakton se:
 - (a) aplikacioni për caktimin e numrit përmbante informata falso, te rreme, apo të pasakta;
 - (b) pranuesi nuk i përmbush më kushtet e specifikuar në këtë ligj;
 - (c) tarifa për numrat e ndarë apo blloqet e numrave nuk është paguar dhe paralajmërimi për mospagesën e tillë është dorëzuar më parë; apo,
 - (d) numrat e ndarë nuk janë duke u përdorur më sipas kushteve të saktësuara në këtë ligj apo në dokumentin e caktimit.
- (6) Numrat e ndarë do të skadojnë:
 - (a) nëse pranuesi i numrit kërkon atë;
 - (b) nëse pranuesi i numrit pushon së ekzistuari; apo
 - (c) me revokimin e numrave të ndarë në pajtim me kushtet e kriteret e përcaktuara të këtij ligji.
- (7) Nëse pranuesi i numrave dështon që të përdorë ndonjërin nga numrat të cilët i janë ndarë brenda periudhës tri vjeçare pas akordimit të tyre, apo dështon në përdorimin e blloqeve të numrave të cilët i janë ndarë për më shumë se një vit, këta numra apo blloqe të numrave të ndara që nuk janë përdorur brenda asaj kohe do të skadojnë.

Nëni 39
Transferimi i numrave të ndarë

- (1) Akordimi i numrave nga një ofrues i shërbimeve nuk mund të transferohet, përveç nëse është përshkruar ndryshë në këtë nën.
- (2) Kur parapaguesit në një rrjet të telefonisë fikse dëshirojnë që t'i ndërrojnë ofruesit e shërbimeve, ata mund ti mbajnë numrat gjeografik të cilët u janë ndarë më parë, me kusht që këta të mbesin në lokacionin e njëjtë gjeografik.
- (3) Kur parapaguesit në një rrjet të telefonisë fikse që mbajnë numra jo-gjeografik dëshirojnë që të ndërrojnë ofruesin e shërbimeve, ata mund ta mbajnë numrin e tyre të

mëparshëm, pa marrë parasysh nëse parapaguesi mbetet apo nuk mbetet në lokacionin e njëjtë gjeografik.

(4) Parapaguesit e identifikuar në paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni që dëshirojnë ti ndërrojnë ofruesit e shërbimeve mund të ngarkohen me një tarifë nga ofruesi i tyre aktual i shërbimeve, por ata mund të ngarkohen vetëm për ato shpenzime që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ndryshimin e parapagimit.

Kapitulli 8 **Ofruesit e shërbimeve**

Nëni 40 Kërkesat themelore

(1) Përveç të gjitha dispozitave tjera aplikative në këtë ligj, të gjithë ofruesit publik të shërbimeve të telekomunikacionit do ti përmbushin kërkesat e këtij kapitulli duke përfshirë kërkesat themelore për:

- (a) sigurinë e veprimtarisë së rrjetës
- (b) mirëmbajtjen dhe integritetin e rrjetës;
- (c) qasjen jo-diskriminuese dhe çmimet
- (d) ndërlidhjen ndërmjet rrjetave; dhe,
- (e) mbrojtjen e konsumatorëve dhe të dhënave.

(2) Të gjithë ofruesit e shërbimeve do të paguajnë tarifën që kërkohen nga ta sipas këtij ligji.

(3) Të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet të jenë të regjistruar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 të dt.08 shkurt 2001 “Mbi Organizatat Afariste”.

(4) Jo më vonë se 2 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjithë personat që ofrojnë shërbime të telekomunikacionit në Kosovë, që kanë ndër mend të ofrojnë shërbime të tilla, duhet të aplikojnë për autorizimin e duhur, licensën, dhënien e pushtetit dhe /ose caktimin e numrave sipas kërkesës së këtij ligji.

Nëni 41 Raportimi

(1) Të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet t'i dorëzojnë ART-it raportet vjetore, duke përfshirë këtu edhe informatat financiare të bazuara në revizionimin e pavarur dhe në pajtim me ligjet e zbatueshme të Kosovës, që do të përfshijnë, ku është e mundur:

- (a) sasinë e të gjithë aksionëve kapitale të lëshuara;
- (b) sasinë dhe privilegjet e secilës kategori të aksionëve;
- (c) shumat e paguara për to dhe mënyra e pagesës;
- (d) pjesë-përkatësitë e fitimit (dividentet) të paguara, nëse ka ndonjë;
- (e) numri i aksionarëve (dhe emrat e 30 mbajtësve më të mëdhej të secilës nga kategoritë e aksionëve dhe sasia që mban secili prej tyre);
- (f) borxhet e financuara dhe borxhet lundruese si dhe kamata që paguhet për to;

- (g) çmimi dhe vlera e pronës, franshizave (lejeve të posaçme) dhe të paisjeve të ofruesit të shërbimeve;
- (h) numri i të punësuarve dhe rrogat e paguara për secilën kategori;
- (i) emrat e të gjithë zyrtarëve dhe drejtorëve, dhe shuma e rrogave, shtesave si dhe të gjithë kompensimeve të tjera të cilat i paguhen secilit;
- (j) shuma e shpenzuar për përmirësime të mëdha (kapitale) gjatë secilit vit;
- (k) të hyrat dhe faturat nga secila degë e biznesit dhe nga të gjithë burimet;
- (l) shpenzimet e veprimit dhe shpenzimet e tjera;
- (m) balansi i fitimit dhe humbjes; dhe
- (n) ekspozimi i plotë i veprimeve financiare të ofruesit të shërbimeve për secilin vit, duke përfshirë edhe pasqyrën vjetore të balansit.

(2) Raportet vjetore duhet të bëhen për dymbëdhjetë muajt e vitit të cilët i zgjedh ART-i dhe do t'i dorëzohen atij jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të vitit për të cilin është kryer raporti, përveç nëse akordohet kohë plotësuese nga ART-i.

Nëni 42 Kontabiliteti

(1) Ofruesit e shërbimeve të rrjetave publike të telekomunikacionit dhe shërbimeve duhet të sigurojnë ndarjen e duhur të niveleve organizative dhe atyre të kontabilitetit me qëllim që të lehtësohet ndarja e të hyrave, shpenzimeve dhe të çmimeve të shërbimeve individuale të telekomunikacionit që ata kryejnë, si dhe që të bëjnë revizionimin vjetor të deklaratave financiare bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në bazë të ligjeve aplikative apo rregulloreve të UNMIK-ut në Kosovë, të publikojnë deklaratat e revizionuara financiare dhe të dorëzojnë një raport vjetor në ART.

(2) Ofruesit e shërbimeve të cilët ofrojnë shërbime publike të telekomunikacionit, përveç shërbimeve të tyre të transmetimit, duhet të mbajnë shënime të ndara financiare në lidhje me aktivitetet e tyre individuale në pajtim me paragrafin (1) të këtij nëni.

(3) ART-i ka të drejtën që të inspektojë shënimet financiare të të gjithë ofruesve të shërbimeve.

(4) ART-i mund të kërkojë nga ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit që të adoptojnë standarde specifike të kontabilitetit me qëllim të parandalimit të subvencionëve të kryqëzuara të shërbimeve dhe me qëllim të përmbushjes së synimeve të tjera të këtij ligji.

Nëni 43 Masat e sigurisë

(1) Ofruesit e shërbimeve publike të telekomunikacionit do të marrin masa të nevojshme teknike dhe organizative, për të mbrojtur sigurinë e shërbimeve të tyre.

(2) Këto masa mbrojtëse do të sigurojnë një nivel të sigurisë dhe mbrojtjes i cili është proporcional me rrezikun e parashikuar dhe shpenzimet, dhe i cili është në përpjestim me nivelin e zhvillimeve teknike të sistemit.

(3) Nëse ekzistojnë gjasa që të depërtohet ilegalisht nëpër sigurimin e rrjetës, ofruesi i shërbimeve do t'i paralajmërojë parapaguesit për këtë rrezik dhe t'i njoftojë parapaguesit për marrjen e masave të mundshme të sigurisë.

(4) Ofruesit e shërbimeve dhe rrjetave publike të telekomunikacionit duhet t'i dorëzojnë ART-it, me kërkesën e tij, detajet që kanë të bëjnë me garantimin e sigurisë, së bashku me një deklaratë e cila deklaron se implementimi i masave parandaluese teknike është bërë apo do të bëhet në një kornizë të caktuar kohore.

(5) Në rast se ART-i vëren mangësi në sistemin e propozuar të masave mbrojtëse sipas këtij nëni apo në implementimin e tyre, ofruesi i shërbimeve duhet t'i korigjojë ato mangësi pas urdhërit me shkrim nga ART-it.

Nëni 44

Ofruesit e shërbimeve me fuqi të konsiderueshme në treg

(1) Për qëllime të këtij ligji, ofruesit e shërbimeve do të konsiderohen se kanë fuqi të konsiderueshme në treg nëse ata mbajnë më shumë se 25 përqind të aktivitetetve afariste të llojit të njejtë në një sektor të veçantë të tregut në Kosovë. Për qëllime të këtij nëni, aksionët në tregun e ofruesve të shërbimeve të cilët janë nënvarës të kompanive të tjera të cilat veprojnë në sektorin e njejtë, apo kompanive të cilat vetëvetiu kontrollojnë kompanitë e tjera të cilat veprojnë në sektorin e njejtë, do të konsiderohen si të njejtë në tërësinë e tyre.

(2) ART-i do të përcaktojë nëse një ofrues i shërbimeve posedon apo jo fuqi të konsiderueshme në treg, me kërkesën e cilitdo ofrues të shërbimeve, apo me vetëiniciativë.

(3) Gjatë vlerësimit nëse ofruesi i shërbimeve ka fuqi të konsiderueshme në treg, ART-i duhet të marrë në konsideratë madhësinë relative të ofruesit të shërbimeve në krahasim me madhësinë e tregut, aftësinë e ofruesit të shërbimeve që të ndikojë në kushtet e tregut, kontrollin e ofruesit të shërbimeve në qasjen e parapaguesve, si dhe burimet financiare të ofruesit të shërbimeve.

Nëni 45

Ndalimi i subvencionimit

(1) Ofruesit e shërbimeve që kryejnë aktivitete të tjera afariste në të cilat ata kanë një fuqi të konsiderueshme në treg përbrenda kuptimit të këtij ligji apo rregullave përkatëse të konkurrencës që janë në fuqi në Kosovë, apo të cilët kanë të drejta të veçanta apo ekskluzive për kryerjen e aktiviteteve specifike afariste apo për shfrytëzimin e resurseve natyrore apo resurseve të tjera të kufizuara në të cilat nuk kanë qasje ofruesit e tjerë të shërbimeve të telekomunikacioneve, do të detyrohen që të bëjnë ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura me telekomunikacionet përmes një njësie tjetër ligjore.

(2) Asnjë ofrues i shërbimeve publike të telekomunikacionit me fuqi të konsiderueshme në treg nuk guxon të kryq-subvencionojë plotësisht shërbimet e ndryshme të telekomunikacionit.

(3) Ofruesit e shërbimeve publike të telekomunikacionit që kanë fuqi të konsiderueshme në treg duhet që në mënyrë të qartë të bëjnë ndarjen e strukturave organizative dhe të shënimeve financiare të aktiviteteve të ndryshme të tyre qëllim që të llogariten në mënyrë të saktë fitimet dhe humbjet e secilit aktivitet afarist individualisht.

Nëni 46

Monitorimi i trafikut të telekomunikacionit

(1) Nëse kërkohet, ofruesit e shërbimeve sipas rregullave aplikative të procedurës penale apo të ndonjë ligji përkatës apo Rregulloreje të UNMIK-ut, me qëllime të paraqitjes/prezentimit të përparimit të procedurave penale apo për sigurinë e Kosovës, duhet që:

- (a) t'i raportojnë autoritetit përkatës informatat që kanë të bëjnë me pjesëmarrësit, porositë si dhe faktet dhe rrethanat e trafikut të telekomunikacionit në rastet individuale, në mënyrën, masën dhe kohëzgjatjen e përcaktuar nga një gjykatë kompetente;
- (b) në bazë të një kërkesë me shkrim, t'i raportojnë autoriteteve përkatëse informatat lidhur me pronarët dhe parapaguesit e shërbimeve të telekomunikacionit, me të cilin do të bëhet trafiku i telekomunikacionit i cili i nënshtrohet urdhërit të gjyqit siç është specifikuar në pikën (a) të këtij nëni; apo
- (c) të ofrojë një ndërlidhje të përshtatshme në rrjetën e tyre që të mbikqyrë trafikun e telekomunikacionit në mënyrën, masën dhe kohëzgjatjen e përcaktuar me urdhëresë gjyqi nga autoriteti përkatës.

(2) Para ekzekutimit të dekreteve të specifikuara në një urdhëresë të tillë, autoriteti përkatës duhet t'i dërgojë ofruesit të shërbimeve një transkript të nënit të urdhëresës së gjyqit në të cilin ceken lidhjet e telekomunikacionit dhe kohëzgjatja e ekzekutimit. Ky transkript i nënit përkatës i urdhëresës duhet të bëhet nga trupi i cili ka dhënë urdhërin.

Nëni 47

Tregimi (ekspozimi) i identitetit të personit që ka telefonuar dhe personit të telefonuar

ART-i do të hartojë dhe publikojë kushtet për identifikimin numerik automatik në rrjet dhe kushtet për sigurimin e këtij shërbimi për publikun.

Nëni 48

Ridrejtimi i telefonatave dhe telefonatat automatike

ART-i do të hartojë dhe publikojë kushtet për ridrejtimin automatik të telefonatave dhe kushtet për sigurimin e kësaj mundësie të rrjetës për publikun.

Kapitulli 9 **Shërbimet universale**

Nëni 49

Parimet e shërbimeve universale

(1) ART-i do të qeveriset si [pas këtij ligji dhe do të marrë parasysh opinionin/mendimin publik që ka të bëjë me definimin, kërkesat dhe mekanizmat përkrahës të shërbimeve univervzale në Kosovë.

(2) Shërbimi univerzal është një zhvillim i shërbimeve të telekomunikacionit të cilin ART-i duhet ta definojë në baza periodike, duke marrë parasyshë përparimet në telekomunikime dhe teknologjinë informative dhe të shërbimeve.

(3) ART-i duhet t'i promovojë shërbimet univerzale në bazë të parimeve në vijim:

- (a) kualiteti dhe çmimet: kualiteti i shërbimeve duhet të ofrohet me çmime të arsyeshme dhe të përballueshme.
- (b) shërbimet themelore: të gjithë parapaguesit në tërë Kosovën duhet që së paku të kenë qasje në shërbimet në vijim:

- (i) telefoni me zë, duke përfshirë telefoninë me parapagim individual apo telefonët publikë me pagesë;
- (ii) ndihmën e adresarit të parapaguesve;
- (iii) Thirrje pa pagesë në shërbimet e emergjencës, duke përfshirë zjarrëfikësit, policinë dhe ambulancën.

(c) qasje në shërbimet e avansuara: qasje në telekomunikacionët e avansuara dhe shërbimet e informatave duhet të ofrohen përgjatë tërë Kosovës.

(d) qasje në vendet rurale dhe rajonë me çmime të larta: konsumatorët në tërë rajonit e Kosovës, duke përfshirë edhe konsumatorët me të ardhura të ulëta, ata në vendet rurale, në vende të izoluara, dhe në rajonë me çmime të larta duhen të kenë qasje në shërbimet e telekomunikacionit dhe informatave, duke përfshirë edhe shërbimet e avansuara të telekomunikacionit dhe informatave të cilat janë në masë të arsyeshme të njëjta me ato shërbime që ofrohen në vendet urbanë, dhe të jenë të arsyeshme në krahasim me çmimet në vendet urbanë.

(e) kontributet e barabarta dhe jo-diskriminuese: të gjithë ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit duhet të bëjnë kontribute të barabarta dhe jo-diskriminuese me qëllim të ruajtjes dhe avansimit të shërbimeve univerzale.

(f) mekanizmat specifikë dhe të parashikueshëm: duhet të ekzistojnë mekanizma financiarë specifikë, të parashikueshëm dhe të mjaftueshëm me qëllim të ruajtjes dhe avansimit të shërbimeve univerzale.

(g) Qasja e komuniteteve në shërbimet e avansuara të telekomunikacionit: shkollat dhe universitetet, ofruesit e shërbimeve shëndetësore, dhe bibliotekat duhet të kenë qasje në shërbimet e avansuara të telekomunikacionit me qëllim të mundësimit të një qasjeje më të gjërë publike në shërbimet e avansuara të telekomunikacionit siç është interneti i brezit të gjërë.

(h) parimet plotësuese: ART-i dhe Ministria mund të përcaktojnë parime plotësuese të shërbimeve univerzale, që janë të përshtatshme për mbrojtjen e interesit publik, të favorshme, nëvojshme dhe që janë në përputhje me këtë ligj.

(4) Ministria gjatë rekomandimit, dhe ART-i gjatë definimit, të atyre shërbimeve që janë mbështetëse të shërbimeve universale do të marrin në konsideratë masën deri në të cilën shërbimet e tilla të telekomunikacionit:

- (a) janë thelbësore për arsimim, shëndetin publik, apo sigurinë publike;
- (b) përmes veprimit të tregut me oferta të shumta, një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve kanë parapaguar për atë shërbim specifik;
- (c) janë duke u ofruar në rrjetat publike të telekomunikacionit nga ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit; dhe

- (d) janë në përputhje me interesin, komoditetin e kërkuar dhe nevojën publike.
- (3) Siç e sheh të arsyeshme, Ministria mund t'i rekomandojë ART-it që të bëjë ndryshime në definimin e shërbimeve të cilat ART-i i konsideron si shërbime universale.
- (4) Si plotësim i shërbimeve të përfshiera në definimin e shërbimeve univerzale në paragrafin (1), ART-i mund të akordojë shërbime plotësuese për mekanizmat e tillë përkrahës për shkolla, biblioteka, dhe ofrues të shërbimeve shëndetësore.

Nëni 50 Tenderi mbi shërbimin fiks

- (1) Pamvarësisht nga dispozitat tjera të këtij nëni, ART-i do të lëshojë një konçesion për shërbime fikse të telekomunikacionit në pajtim me procedurat për tenderim publik dhe ankande. Ministria do të pregatisë dokumentet e tenderit ndërsa ART-i do të implementojë tenderin dhe të gjitha aspektet e tenderit do të bëhen me transparence të plotë.
- (2) Jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ART-i në emër të Ministrisë do të mbajë një tender me konkurrencë ndërkombëtare për së paku 150,000 linja të reja, me synim të veçantë për vendosjen e linjave në vendet rurale dhe ato me shërbime të mangëta. Ministria do të caktojë sasinë e linjave që do të dërgohen në secilën nga (30) juridiksionët komunale që duhet të instalohen nga konçesionari brenda fazës 3 vjeçare të ndërtimit sipas kontratës që ka për qëllim ngritjen për 10 përqind të thellësisë së depërtimit të shërbimeve themelore telefonike në Kosovë.
- (3) Konçisioni do të përmbajë edhe stimulime për instalimin e shpejtë të linjave dhe dënime financiare për mospërmbushjen e kërkesave të kontraktuara për instalimin e tyre.
- (4) Konçisionari fitues duhet t'u ofrojë të gjithë shfrytëzuesve të tij qasje në adresarët e parapaguesve dhe qasje të liruar prej pagesës në shërbimet e emergjencës, duke përfshirë policinë, zjarrëfikësit dhe ndihmën e shpejtë mjekësore.
- (5) Si pjesë e kontratës së konçisionit, ART-i do t'i vërë në dispozicion konçisionërit fitues burime të spektrit frekuencor në mënyrë që ai t'u ofrojë shërbime shfrytëzuesve përmes lakut lokal ajror/pa tel, si dhe përmes sistemeve mikrovalore digjitale për ndërlidhje të rrjetës; e drejta standarde për përdorimin e tarifave për akordime të tilla të spektrit do të jetë e përjashtuar nga dispozitat tjera mbi ankandet për frekuenca të ndara.
- (6) Konçisionëri fitues do të veprojë në përputhshmëri me kushtet e këtij ligji dhe të ligjeve tjera të Kosovës.

Nëni 51 Tenderi fiber optik

Jo më vonë se 6 muaj prej datës së hyrjes së këtij ligji në fuqi, Ministria do të mbledhë dokumentacionin e nevojshëm dhe do të publikojë një tender ndërkombëtar për krijimin e një lidhjeje të optimizuar të sistemit të telekomunikacionit në Kosovë me njërin nga lidhjet

ndërkombëtare të telekomunikacionit përmes fibrave optik. Ministria do të pregatisë dokumentet e tenderit ndërsa ART-i do të implementojë tenderin.

Kapitulli 10 **Rrjetat dhe shërbimet e telekomunikacionit**

Nëni 52 Rrjetat e telekomunikacionit

- (1) Rrjetat publike të telekomunikacionit do të krijohen për të ofruar shërbime të telekomunikacionit për të gjithë përdoruesit në baza jo-diskriminuese përgjatë gjithë Kosovës.
- (2) Të gjithë rrjetat publike të telekomunikacionit do të ndërlidhen më njëra tjetrën dhe më rrjetat tjera ndërkombëtare sipas standardeve ndërkombëtare.
- (2) Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetave të pavarura publike të telekomunikacionit do të bëhet nga ofruesit e licensuar të shërbimeve.

Nëni 53 Lidhjet (interfejsët)

- (1) Ofruesit e shërbimeve publike të telekomunikacionit që kanë fuqi të konsiderueshme në treg duhet të ofrojnë lidhje sipas standardeve të përcaktuara nga ART-i.
- (2) Nëse një shfrytëzues apo ofrues i shërbimeve kërkon një lidhje të veçantë apo qasje të veçantë nga ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit që kanë fuqi të konsiderueshme në treg, atëherë ai ofrues duhet të përmbushë atë kërkesë nëse ajo është e arsyeshme dhe nëse nuk çon drejt diskriminimit ndërmjet shfrytëzuesve. Sipas këtij nëni, çfarëdo rrefuzimi nga ofruesit të shërbimeve duhet të dorëzohet jo më vonë se 30 ditë pasi që është bërë kërkesa dhe me të duhet të jenë të bashkangjitura edhe arsyet për një refuzim të tillë për lidhje të veçantë.
- (3) Ofruesit e shërbimeve me fuqi të konsiderueshme në treg të cilët ofrojnë qasje të veçantë apo lidhje të veçantë duhet t'a bëjnë atë mbi baza të bazuara në çmim. ART-i mund t'i marr nën shqyrtim tarifat dhe të përcaktojë formulën financiare për sasinë e çmimit apo të imponojë kufizime në tarifa.
- (4) Ofruesit e shërbimeve publike të telekomunikacionit që kanë fuqi të konsiderueshme në treg duhet të publikojnë dhe t'i ofrojnë ART-it informata lidhur me llojet e lidhjeve që kanë në dispozicion, lokacionin e tyre si dhe specifikacionët e tyre teknike.
- (5) ART-i mund të urdhërojë cilindo ofrues të shërbimeve që të ofrojë lidhje standarde, lidhje të veçanta, qasje të veçantë apo të përcaktojë kushtet për një qasje të tillë.
- (6) ART-i do të publikojë udhëzimet për ofrimin e lidhjeve sipas këtij nëni.

Nëni 54 Dhënja me qira e lidhjes

- (1) Ofruesit e shërbimeve që kanë fuqi të konsiderueshme në treg për ofrimin e lidhjeve

me qira duhet të sigurojnë kapacitet të mjaftueshëm të lidhjeve që do të përfshijë të gjithë lidhjet e specifikuar në nënin 53 të këtij ligji, në të gjithë hapësirat gjeografike në të cilat ata ofrojnë shërbime të dhënjes së lidhjeve me qira.

(2) Çfarëdo marrëveshje ndërmjet ofruesve të shërbimeve që ka të bëjë me ofrimin e përbashkët të kapaciteteve apo lidhjeve duhet t'i prezentohet ART-it kur ai e kërkon këtë.

Nëni 55

Shërbimet publike të telefonisë fikse

- (1) Të gjithë ofruesit e shërbimeve të telefonisë publike do të ofrojnë qasje në:
 - (a) ndihmë përmes adresarëve apo shërbime të tjera të informatave lidhur me parapaguesit e telefonëve;
 - (b) ndihmë përmes operatorit (sekretarisë) duke përfshirë edhe ndihmë në vendosjen e lidhjeve (lidhjen ndërmjet dy parapaguesve);
 - (c) qasje pa pagesë në numrat e emergjencës, duke përfshirë zjarrfikësit, policinë, ambulancën si dhe shërbimet tjera që gjinden në rekomandimet e CEPT-it;
- (2) Të gjithë ofruesit e shërbimeve të telefonisë publike do t'i furnizojnë parapaguesit e tyre me një deklaratë të shërbimeve të cilat ofrohen nga ata, si dhe të kushteve në bazë të të cilave ofrohen shërbimet e tilla, duke përfshirë në minimum, kohën e lidhjes fillestare, mirëmbajtjen, kompenzimin për pengesa në shërbim, nivelin e shërbimeve si dhe procedurat për ankesa.
- (3) ART-i mund të urdhërojë ofruesin e shërbimeve që t'i ndryshojë kushtet e tij të përgjithëshme nëse ato nuk janë në pajtim me këtë ligj.
- (4) Të gjithë ofruesit e shërbimeve të telefonisë publike duhet të përmbushin kërkesat për lidhje të nënit 53.
- (5) Ofruesit e shërbimeve të telefonisë publike duhet të përmbushin të gjithë synimet e paraqitura nga ART-i për përmirësimin e kualitetit të shërbimit.
- (6) Kërkesat e këtij nëni nuk do të jenë aplikative edhe për ofruesit e shërbimeve publike radio mobile, të shërbimeve me të dhëna duke përfshirë *në mes tjerash*, porositë e shkurtëra SMS (Short message services), GPRS (Global Packet Radio Service) dhe pejxhimin.

Nëni 56

Qasja e hapur në rrjeta të ndryshme

- (1) Të gjithë ofruesit e shërbimeve do të ndihmojnë dhe përmirësojnë komunikimet ndërmjet shfrytëzuesve të rrjetave të ndryshme publike të telekomunikacionit.
- (2) Ofruesit e shërbimeve do të ofrojnë ndërlidhje të përbashkta të rrjetës të bazuara në kërkesat e parashtruara në këtë ligj.
- (3) Informatat konfidenciale të marrura nga ofruesit e shërbimeve përmes procesit të definimit të standardeve të ndërlidhjeve të rrjetave dhe lidhjeve duhet të mbrohen.

(4) Me kërkesën e ofruesit të shërbimeve, ART-i mund të ofrojë lirim të pjesërishtë apo të plotë nga obligimi për ndërlidhje të rrjetës në bazë të rrethanave, të mangësive hapësinore, teknike apo afariste, si dhe burimeve të kufizuara. Informatat mbi çfarëdo përjashtimi të pjesërishtë apo të plotë që sigurohen sipas këtij nëni do t'u sigurohen pa pagesë çfarëdo personi që ART-i mendon se ka interes legjitim.

(5) Gjatë marrjes së vendimit nëse duhet të zbusë obligimin për t'u ndërlidhur me ofruesit e huaj të shërbimeve, ART-i duhet të marrë parasysh kushtet e dekreteve ligjore ndërkombëtare të cilat janë aplikative në Kosovë, reciprocitetin dhe çfarëdo efekti negativ në konkurrencë që mund të shfaqet nga një vendim i tillë.

(6) Ofruesit e shërbimeve do të diskutojnë kushtet përfundimtare dhe kushtet teknike të ndërlidhjeve të rrjetave të cilat do të finalizohen me një kontratë me shkrim. Kjo kontratë duhet të pasqyrojë të gjithë kërkesat e parashtruara në këtë ligj. Në bazë të kërkesës me shkrim nga ART-i, ofruesi i shërbimeve do të furnizojë atë me kontratat e kërkuara për ndërlidhje të rrjetave. Kontratat për ndërlidhje të pranuar nga ART-i do të bëhen publike, përveç informatave specifike që sipas të dyja palëve janë konfidenciale.

(7) Në rast se ofruesit e shërbimeve dështojnë në arritjen e një marrëveshjeje mbi ndërlidhjen, ART-i duhet që jo më vonë se 6 javë pas kërkesës së cilësdo nga palët, të vendosë procedurat, afatët e fundit dhe kushtet, duke përfshirë edhe kapacitetin, në pajtim me të cilat ofruesit e shërbimeve duhet të ofrojnë ndërlidhje. Ofruesit e shërbimeve duhet të përmbushin kushtet e urdhërave me shkrim nga ART-i brenda 30 ditësh.

(8) Ofruesit e shërbimeve mund të ndryshojnë ndërmjet veti sa ka të bëjë me çmimet, kushtet dhe afatët e fundit që janë të aplikueshme për kategoritë e ndryshme të shfrytëzuesve, me kusht që ndryshimet e tilla të jenë proporcionale me llojin e ndërlidhjes së rrjetave. Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë që të përdorë lloje të ndryshme të shfrytëzuesve në një menyrë e cila do të mund të kufizonte në masë të paarësyeshme konkurrencën.

Nëni 57

Qasja e hapur në rrjeta dhe shërbime

(1) Ofruesit e shërbimeve publike të telekomunikacionit që kanë fuqi të konsiderueshme në treg, duhet të ofrojnë shërbime dhe qasje në rrjetat e tyre në bazë të kushteve të publikuara, të bazuara në çmim, transparente dhe objektive të cilat mbulojnë të gjithë aktivitetet që kanë të bëjnë me sigurimin e qasjes, duke përfshirë, mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në, informatat e nëvojshme për sigurimin e qasjes, kushtet e ndërlidhjes dhe orarin sigurimit të një qasjeje të tillë.

(2) Kushtet e specifikuar në paragrafin (1) të këtij nëni duhet të jenë të ngjashme për shërbimet e ngjashme në rrethana të ngjashme, dhe duhet të jenë të njëjta me kushtet që ofruesi i shërbimeve i ofron vetës apo ndonjë filiale të sajë apo kompanive ndihmëse për shërbime të njëjta.

(3) Në rast se ofruesi i shërbimeve rrefuzon apo i ndalon konsumatorit qasje në rrjet apo shërbime, ofruesi i shërbimeve duhet të informojë ART-in mbi arsyetimet e tija teknike për atë refuzim jo më vonë se 10 ditë pasi që kjo të ketë ndodhur.

Kapitulli 11 **Pajisjet e telekomunikacionit**

Nëni 58

Radio pajisjet dhe терминаlet

- (1) Radio pajisjet dhe терминаlet që janë në përputhje me kushtet e këtij ligji mundën që lirisht të nxirren në treg, të transferohen dhe të përdoren në Kosovë, me kusht që instalimi dhe mirëmbajtja e tyre të bëhet në mënyrë të duhur.
- (2) Ofruesit e shërbimeve do të lejojnë ndërlidhjen e pajisjeve radio apo terminale me lidhje adekuatë që janë në përputhshmëri me dispozitat e këtij ligji.
- (3) Të gjithëa radio pajisjet dhe ato terminale të prodhuara në përputhshmëri me standardet aplikative të lëshuara nga Instituti Evropian për Vendosjen e Standardeve, do të konsiderohen si të aplikueshme në Kosovë.
- (4) Paragrafi (1) i këtij nëni është i aplikueshëm në masë të barabartë për pajisjet mjekësore dhe mjetet e motorizuara që kanë radio pajisje apo terminale që u janë instaluar si pjesë përbërëse apo pjesë shtesë.
- (5) Dispozitat e këtij kapitulli nuk do të vlejné për:
 - (a) pranuesit e dizajnuar ekskluzivisht për pranimin e kanaleve transmetuese të radios apo televizionit;
 - (b) instalimet e kablove dhe telave për pranimin e kanaleve transmetuese;
 - (c) pajisjet për radio dhe terminale që janë ta mbuluara me ligje specifike apo rregullore të UNMIK-ut;
 - (d) pajisjet për radio dhe terminale që përdoren ekskluzivisht për ofrimin e sigurisë dhe emergjencës civile, mbrojtjen si dhe mbrojtjen nga fatëkeqësitë natyrore apo fatëkeqësitë tjera në Kosovë;
 - (e) radio pajisjet e vetë-prodhuara nga pjesë të ndryshme, përveç nëse një pajisje e tillë shitet në treg; ART-i do të krijojë dhe publikojë me shkrim procedurat të cilat qeverisin përdorimin e pajisjeve të tilla të specializuara.

Nëni 59

Kërkesat themelore për radio pajisjet apo терминаlet

- (1) Të gjithëa radio pajisjet apo терминаlet e prodhuara apo të përdorura në Kosovë:
 - (a) nuk do të dëmtojnë ambientin apo përdoruesin;
 - (b) nuk do të ndikojné negativisht në shëndetin apo sigurinë; dhe
 - (c) do të përdorin me efektshmëri brezin frekuencor për radio komunikime tokësore, ajrore dhe orbitale dhe do të evitojnë ndërhyrjet e dëmshme, duke përfshirë EMC.
- (2) ART-i mund të ndalojë apo të kufizojë tregëtimin, shitjen apo përdorimin e një pjesë të veçantë të radio-pajisjeve nëse rrezikon:

- (a) veprimin e shërbimeve radio-drejtuese
 - (b) shërbimet që kanë për qëllim ofrimin e sigurisë të Kosovës apo mbrojtjes së Kosovës;
shërbimet që kanë për qëllim mbrotjen nga fatkeqësitë natyrore apo emergjenca tjera
 - (c) dëmtim serioz, ndërhyrje të vazhdueshme apo pengesa të shërbimeve radio-komunikuese
- (3) ART-i mund të publikojë një listë të standardeve të pranueshme të radio pajisjeve dhe terminaleve në faqenë tij zyrtare në internet.

Nëni 60

Tregëtimi dhe shfrytëzimi i paisjeve për radio dhe terminale

- (1) Radio paisjet dhe terminalët që nuk përmbushin kushtet e këtij ligji dhe rregulloreve dhe/apo udhëzimeve të lëshuara në pajtim me këtë ligj nuk do të tregëtohen, të shiten apo të shfrytëzohen në territorin e Kosovës.
- (2) Inspektorët të emëruar në mënyrë specifike nga ART-i për atë qëllim mund të ndalojnë tregëtimin, shitjen apo shfrytëzimin e paisjeve të cekura në paragrafin një (1) të këtij nëni apo mund të adoptojnë masa të tjera të miratuara në mënyrë specifike nga ART-i, që kanë për qëllim ndalimin e tregëtimit, shitjes apo shfrytëzimit të tyre në territorin e Kosovës.
- (3) Nëse paisja për radio dhe terminale që është e etiketuar qartazi apo për të cilën deklarohet se është në pajtim me kërkesat e këtij ligji i shkakton dëme të konsiderueshme rrjetës, emiton radio ndërhyrje të dëmshme apo shkakton dëme të tjera në veprimin e rrjetës, ofruesi i shërbimeve mund t'a përjashtojë atë apo ta nxjerrë prej përdorimit. Ofruesi i shërbimeve do t'ë njoftojë shfrytëzuesin dhe ART-in për një përjashtim të tillë të pajisjes pa vonësë, dhe ART mund të konfirmojë apo ndalojë një përjashtim të tillë.
- (4) ART do të përshkruajë procedurat për verifikimin dhe shënjim/etiketimin e paisjeve të radio dhe terminaleve në pajtim me paragrafet e këtij neni dhe gjithëashtu duhet t'i bëjë informatat e tilla publike.

Nëni 61

Kërkesat për paisjet elektronike

- (1) Të gjithëa paisjet elektrike të telekomunikacionit që shfrytëzohen, tregëtohen apo prodhohen në Kosovë duhet të përputhen me kushtet në vijim:
- (a) mos t'ë dëmtojnë ambientin apo shfrytëzuesin;
 - (b) mos të ndërhyjnë me shëndetin dhe sigurinë publike;
 - (c) ndërhyrjet elektromagnetike të cilat ato shkaktojnë të mos e tejkalojnë nivelin i cili i lejon paisjet e radios dhe telekomunikacionit si dhe mjetet e tjera elektrike të veprojnë në mënyrën në të cilën ato janë dizajnuar për të vepruar;
 - (d) të kenë një nivel adekuat të rezistencës ndaj ndërhyrjeve elektromagnetike që u lejon atyre të veprojnë në mënyrën në të cilën janë dizajnuar.
- (2) Kushtet e këtij neni nuk do të vlejnjë për:

- (a) Enërgjinë elektrike apo rrjetat për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e saj;
- (b) sinjalet nga radio transmetuesit; apo
- (c) radio paisjet e vetë-punuara nga pjesët të ndryshme, përveç nëse ato tregëtohen; ART-i do të krijojë dhe publikojë me shkrim procedurat të cilat qeverisin përdorimin e pajisjeve të tilla të specializuara.

Nëni 62

Tregëtimi dhe shfrytëzimi i pajisjeve elektrike

- (1) Pajisjet të prodhuara në Kosovë apo të importuara për përdorim në Kosovë duhet t'i përmbushin kërkesat e këtij ligji. Përmbushja e këtij obligimi do të provohet me anë të dokumenteve, etiketimit dhe simboleve të specifikuara nga ART-i.
- (2) Kur, si rezultat i ndërhyrjeve elektromagnëtiqe, paisjet elektrike apo pjesët e tyre nuk përmbushin më kërkesat e këtij nëni, pronarët e tyre me shpenzimet e tyre, duhet t'i rregullojnë mjetet elektrike dhe t'i kthejnë ato pajisje në gjendjen në të cilën ato i përmbushin plotësisht kërkesat e këtij ligji, nëse një gjë e tillë nuk arrin të bëhet, atëherë ata duhet t'i heqin ato pajisje nga përdorimi në territorin e Kosovës.
- (3) Inspektorët e emëruar nga ART-i do të ndalojnë tregëtimin, shitjen apo shfrytëzimin e çfarëdo mjeti elektrik i cili nuk i përmbush kërkesat e këtij ligji.
- (4) Mjetet elektrike të cilat janë disejnuar për qëllime arsimore apo provuese mund të tejkalojnë nivelin e lejueshëm të prodhimit të ndërhyjeve elektromagnëtiqe, me kusht që ato janë të jenë të disejnuara për studimin e fenomenëve elektromagnëtiqe dhe gjithëashtu me kusht që të jenë ndërmarrë masa të arsyeshme me qëllim të sigurimit që këto mjete të mos ndërhyjnë me mjetet e tjera elektrike në afërsi.
- (5) Për paisjet e komplikuar elektrike të cilat nuk i përmbushin kërkesat që janë të lidhura me kompatibilitetin elektromagnëtik, ART-i mund të lëshojë një liçensë për punë/veprim e cila është me fushëveprim, kohë dhe hapësirë të kufizuar, me kusht që të jenë ndërmarrë masa të arsyeshme për të siguruar që këto mjete mos të ndërhyjnë me mjetet e tjera elektrike në afërsi.
- (6) ART duhet të përshkruajë procedurat për verifikimin dhe etiketimin e paisjeve elektrike në pajtim me kushtet e këtij nëni dhe duhet t'i bëjnë këto informata publike.

Kapitulli 12

Radio komunikimet, akordimi i burimeve të spektrit frekuencor, plani numerik i shërbimeve të telekomunikacionit

Nëni 63

Menaxhimi i spektrit të radio frekuencave

- (1) Spektri i radio frekuencave është një burim i kufizuar natyror. Menaxhimi i frekuencave është pushtet i rezervuar për PSSP-në, i cili ka vënë në dispozicion të IPVQ-së një saj të caktuar për të i'u akorduar shfrytëzuesve dhe ofruesve të shërbimeve. ART-ja do tu caktoj ofruesve të shërbimeve vetëm ato burime spektrale të cilat në mënyrë të veçantë janë ndarë nga PSSP-ja.

- (2) Me qëllim të mbrojtjes së shfrytëzimit efikas dhe pa ndërhyrje të burimeve të spektrit të radio frekuencave të Kosovës si dhe të drejtat e tyre të pozitive orbitale, ART do të:
- (a) krijojë planin për burimet e spektrit me qëllim të ndarjes së radio frekuencave dhe/apo ndarjen e radio frekuencave për shfrytëzim;
 - (b) bëjë ndarjen e atyre brezeve të radio frekuencave dhe/apo ndarje e radio frekuencave për shfrytëzim;
 - (c) bëjë mbikqyrjen përdorimit të tyre.
- (3) Plani i ART-it për burimet e spektrit do të hyjë në fuqi pasi shqyrtimit dhe miratimit paraprak me shkrim nga PSSP-ja. Të gjitha miratimet e burimeve të spektrit që do ti caktoj ART, operuesve të shërbimeve duhet të jenë të ndara nga PSSP-ja.
- (4) ART-i do t'i mbajë të gjithëa informatat përkatëse që kanë të bëjnë me ndarjen e burimeve të spektrit, informatat mbi akordimin e radio frekuencave, si dhe informatat tjera përkatëse që nëvojiten për menaxhimin efektiv të burimeve të spektrit.
- (5) Me përjashtim të informatave që janë të lidhura me kërkesat për sigurimin e Kosovës dhe/apo mbrojtjen e Kosovës, të gjithëa informatat e specifikuar në këtë nën duhen të bëhen publike nga ART-i.

Nëni 64

Plani për akordimin e burimeve të spektrit

- (1) Në planin e tij për ndarjen e burimeve të spektrit dhe të brezeve të radio frekuencave, ART-i duhet t'i definojë radio frekuencat apo brezet e radio frekuencave që janë të dedikuara për radio komunikimeve individuale dhe në mes të grupeve individuale të shfrytëzuesve dhe do të vendosë kushtet sipas të cilave mund të shfrytëzohen radio frekuencat.
- (2) Jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit nga PSSP-ja, ART-i, në bashkëpunim dhe ndihmën e ofruar PSSP-së, do të bëjë publik planin e tij për burimet e spektrit i cili duhet të jetë në pajtueshmëri me ligjet vendore dhe ato ndërkombëtare si dhe Rregulloret e UNMIK-ut të cilat janë të detyrueshme në Kosovë. Plani duhet t'ë marrë parasyshë kërkesat e sigurisë së Kosovës, mbrojtjes dhe emergjencave, si dhe nëvojat për mbrojtjen kundër fatëkeqësive natyrore dhe fatëkeqësive të tjera.
- (3) Në bazë të planit të burimeve të spektrit, ART-i duhet të raportojë PSSP-së mbi të gjitha frekuencat rajonale dhe mbi masën në të cilën ato janë të zëna.

Nëni 65

Planët për shfrytëzimin e radio frekuencave

- (1) Plani i burimeve të spektrit do të përcaktojë në mënyrë të detajuar shfrytëzimin e radio frekuencave brenda brezeve të radio frekuencave që u janë dedikuar shërbimeve individuale sipas planit për ndarjen e radio frekuencave dhe brezeve të radio frekuencave, dhe do të vendosë kushtet e përdorimit të tyre.
- (2) ART-i do të administrojë planin e përshkruar në këtë nën.

Nëni 66
Shfrytëzuesit ekzistues të radio frekuencave

(1) Jo më vonë se 60 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ART-i do t'i njoftojë me shkrim të gjithë shfrytëzuesit ekzistues të burimeve të spektrit akordimet e të cilëve hyjnë nën planin e burimeve të spektrit të miratuar nga PSSP-ja, mbi dispozitat e këtij kapitulli. Të gjithë mbajtësit ekzistues të autorizimeve për mbajtjen e burimeve të spektirt do të mbajnë të drejtën e tyre që i'u është akorduar nga UNMIK-u për gjithë kohëzgjatjen e autorizimit, me kusht që ata të paguajnë tarifën për të drejtën e shfrytëzimit të burimeve të spektrit:

- (a) të jenë njësi ligjore të regjistruara si individ apo njësi bisnesore në Kosovë
- (b) të përputhen me kushtet e përgjithëshme aplikative për të drejtën e shfrytëzimit të spektrumit; dhe
- (c) që të paguajnë tarifën aplikative për të drejtën e përdorimit.

Nëni 67
Shfrytëzimi i përbashkët i pajisjeve të antenës

(1) Marrësit e të drejtës për shfrytëzimin e radio frekuencave do të pajtohen për shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve të antenës, mjeteve dhe instalimeve, duke marrë parasysh të gjithë parametrat e rëndësishëm teknikë.

(2) Në rast se marrësit e të drejtës dështojnë që të pajtohen për shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve të antenës në pajtim me paragrafin (1) të këtij nëni, ata mund t'i drejtohen ART-it që ai të zgjidhë konfliktin në pajtim me procedurat për zgjidhjen e konflikteve të cilat janë përcaktuar me këtë ligj.

Nëni 68
Menaxhimi i planit numerik

(1) ART-i duhet të përegatisë një plan numerik, t'i ndajë numrat dhe blloqet e numrave dhe t'i administrojë ato në mënyrë jodiskriminuese.

(2) ART do ta bëjë planin e vet numerik publik.

(3) Plani numerik duhet të parashohë strukturën, gjatësinë, kapacitetin dhe qëllimin e numrave të ndarë.

(4) Plani numerik do të lejojë prezentimin e shërbimeve të reja vendore dhe ndërkombëtare, sigurojë transferueshmërinë e numrave, bëjë definimin e prefiksëve (numrave hyrës), numrave të shkurtër, si dhe të numrave me rëndësi gjeografike.

(5) Detajet lidhur me çfarëdo ndryshimesh apo shtesash në planin e numërimit duhet të publikohen jo më pak se 1 vit para fillimit të implementimit.

(6) Ofruesit e shërbimeve dhe shfrytëzuesit e tjerë nuk kanë të drejtën për kompensim për ndryshimet e bëra në planin e numërimit.

Kapitulli 13 **Mbrojtja e konsumatorit dhe fshehtësitë personale (intimiteti)**

Nëni 69 Të drejtat e konsumatorit

- (1) Të gjithë personat kanë të drejtë të përdorimit dhe qasjes në shërbimet publike të telekomunikacionit në baza transparente dhe jo-diskriminuese përgjatë gjithë Kosovës.
- (2) Faturat, kontratat e konsumatorëve dhe shpalljet, me shkrim, verbale, të regjistruara apo të transmetuara do të shpërndahen në gjuhët zyrtare, pa diskriminim, sipas ligjeve të Kosovës.
- (3) Përveç të drejtave tjera të konsumatorit të parashtruara në këtë ligj, të gjithë shfrytëzuesit kanë të drejtë për qasje në numrat e telefonit, shërbimet emergjente dhe shërbimet tjera universale siç kërkohet nga ky ligj.

Nëni 70 Mardhënjet kontraktuese dhe kërkesat gjuhësore

- (1) Të gjithëa mardhënjet ndërmjet një ofruesi të shërbimeve dhe një klienti do të përmbillen në një kontratë me shkrim e cila specifikon kohën e lidhjes, llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes që ofrohen, kompensimi dhe/apo rimbursimi si dhe një përmbledhje të procedurave për zgjidhjen e konflikteve. Sa ka të bëjë me shërbimet me parapagim, ofruesi i shërbimeve do tu dërgojë kushtet e tija shitësve të tij në teren në mënyrë që ata pastaj t'i shpërndajnë informatat shfrytëzuesve.
- (2) Dispozitat e kontratave të cilat kanë të bëjnë me kompensin dhe/apo rimbursimin, të bazuara në ndërprerjen e shërbimeve apo reduktimit në qasje, do të vendosin nivelin maksimal që mund t'u rimbursohet shfrytëzuesve. Niveli maksimal i rimbursimit për shfrytëzuesit nuk do të jetë aplikativ nëse ky nivel maksimal është në disproporcion me dështimin e shërbimit dhe dëmtimin e shkaktëuar.
- (3) Një ofrues i shërbimeve do të furnizojë ART-in me të gjitha kontratat, nëse kërkohet. ART-i mund të shqyrtojë kontratën për të siguruar se ajo është në përputhshmëri me kushtet e përgjithëshme të ofruesit të shërbimeve dhe në rast të konflikteve.

Nëni 71 Specifikimi i hollësishëm i thirrjeve

- (1) Me kërkesën e parapaguesit, ofruesit e shërbimeve të telefonisë fikse publike dhe radio shërbimet publike mobile duhet të bëjnë faturimin e hollësishëm, i cili duhet të jetë mjaft i detajuar që t'i mundësojë shfrytëzuesit të shërbimeve të telefonit që thirrjet individuale t'i vërtetojë/verifikoj. Ofruesi i shërbimeve mundet, mirëpo nuk është i detyruar, që të vendosë në listën e hollësishme edhe numrat pa pagesë apo numrat e shërbimeve emergjente.
- (2) Parapaguesi ka të drejtë të zgjedhë në mes të një apo më shumë niveleve të faturimit të hollësishëm, të cilat do të definoohen nga ofruesi i shërbimeve sipas kushteve të tij të përgjithëshme.

(3) Çmimet për specifikimin plotësues më të hollësishme të cilat kërkohen nga ofruesi i shërbimeve për shërbime të tilla do të bazohen në çmimet aktuale të ofruesit të shërbimeve për përgatitjen e tyre.

(4) Ofruesit e shërbimeve duhet t'i ofrojnë ART-it modelet/mostrat e faturave të hollësishme, së bashku me kushtet e tyre.

Nëni 72 Mos-pagimi i faturave

(1) Të gjithë ofruesit e shërbimeve që i ofrojnë publikut shërbime të telekomunikacionit duhet të publikojnë në kushtet e tyre të përgjithëshme detajet që kanë të bëjnë me masat që do të ndërmerren dhe procedurat që do të aplikohen në rast të mospagesës së faturave.

(2) Ofruesi i shërbimeve i cili i ka përmbushur kushtet e paragrafit (1) të këtij nëni mund të çkyqë shfrytëzuesin i cili është fajtor për mospagimin e pagesës apo një pjese të pagesës, sidoqoftë duke marrë parasysh që më parë të jetë dorëzuar një njoftim për mospagim nga ofruesi i shërbimeve tek shfrytëzuesi në përputhje me kushtete e përcaktuara në kushtete e përgjithëshme të ofruesit të shërbimeve.

(3) Shfrytëzuesi mund të parashtrojë ankesë apo vërejtje lidhur me faturën, me kusht që ajo ankesë apo vërejtje t'i dorëzohet ofruesit të shërbimeve jo më vonë se 15 ditë pas pranimit të faturës. Ankesa do të procesohet në përputhje me dispozitat e nënit 73 të këtij ligji

Nëni 73 Ankimi dhe zgjidhja e debatëve

(1) Të gjithë shfrytëzuesit kanë të drejtë që të parashtrojnë ankesa në autoritetin apo organin adekuat të krijuar nga ofruesi i shërbimeve publike të telekomunikacionit apo rrjetave mbi çfarëdo vendimi apo sjellje.

(2) Të gjithë ofruesit e shërbimeve që bëjnë ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit publikut, si pjesë përbërëse të kushteve të përgjithëshme të ofruesit të shërbimeve, duhet të publikojnë një përmbledhje të procedurave të cilave duhet t'u përmbahet gjatë procesit të adresimit të ankesave të shfrytëzuesve.

(3) Ankesat apo kundërshtimet ndaj një fature duhet të dorëzohen jo më vonë se 15 ditë pas pranimit të tyre, ndërsa ankesat tjera duhet të dorëzohen jo më vonë se 30 ditë pas veprimit të ofruesit të shërbimeve, heqjes së veprimit, apo vendimit i cili ka shkakëtuar një veprim të tillë.

(4) Ofruesi i shërbimeve do të vendosë mbi vlefshmërinë e ankesës apo kundërshtimit jo më vonë se 15 ditë pas pranimit të saj.

(5) Në rast se ofruesi i shërbimeve dështon që të mbështesë ankesën apo kundërshtimin apo dështon që të marrë një vendim gjatë periudhës 15 ditëshe, pra ankuese apo kundërshtuese mund të parashtrojë një apel në ART Brenda 15 ditëve të ardhshme.

(6) Në rast se një shfrytëzues parashton një kundërshtim apo një apel në ART sipas këtij

nëni, ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë që të shkyqë apo të mos i ofrojë shërbime shfrytëzuesit. Kjo ndalesë do të mbesë në fuqi deri në përmbylljen e procesit të apeleve.

Nëni 74

Konfidencialiteti i telekomunikacionit

(1) Të gjithë ofruesit e shërbimeve të rrjeteve/shërbimeve të telekomunikacionit si dhe secili person që merr pjesë në ofrimin e shërbimeve të tilla duhet të mbrojë konfidencialitetin e telekomunikacionit, dhe ky obligim duhet të mbetet edhe pasi të jenë përfunduar të gjitha aktivitetet të cilat ata kanë qenë të obliguar t'i ruajnë.

(2) Personat të cilët u janë nënshtruar kushteve të këtij nëni nuk duhet të marrin informata që kanë të bëjnë me përmbajtjen, faktet apo rrethanat e porosive të transmetuara duke tejkaluar ashtu edhe minimumin absolut të nevojshëm për veprimin e shërbimeve individuale të telekomunikacionit. Këta persona do të kenë të drejtën të shfrytëzojnë ato informata vetëm për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit dhe implementimit të obligimeve të kontraktuara për lidhje.

(3) Të gjithë ofruesit e shërbimeve të cilët gjatë ofrimit të shërbimeve të telekomunikacionit, marrin informata lidhur me përmbajtjen e porosive të transmetuara, apo kopjojnë apo ruajnë porositë e transferuara, duhet të njoftojnë shfrytëzuesin për atë gjatë nënshkrimit së kontratës apo me fillimin e ofrimit të shërbimeve të telekomunikacionit dhe duhet t'i shpjegojë shfrytëzuesit arsyet për atë, dhe duhet t'i fshijë informatat për përmbajtjen e porosisë apo edhe vetë porosinë sa më parë që të jetë teknikisht e mundshme dhe në momentin që më nuk do të jetë e nevojshme për ofrimin e një shërbimi të veçantë.

(4) Të gjithëa format e monitorimit, shpërndarjes, ndërhyrjes/kapjes dhe incizimit të porosisë të cilat transmetohen përmes shfrytëzimit të rrjeteve dhe shërbimeve të telekomunikacionit duhet të jenë të ndaluara, të vetmet përjashtime mund të jenë ato që janë në pajtim me këtë nën.

(5) Marrësi i porosisë mund të incizojë atë, mirëpo duhet të njoftojë dërguesin për atë apo të përshtatë veprimin e mjetit incizues në atë mënyrë që dërguesi i porosisë të lajmërohet për këtë veprim, përveç kur kemi të bëjmë me shërbime të telekomunikacionit në të cilat incizimi i porosive nga marrësi është një komponentë apo qëllim i shërbimeve specifike të telekomunikacionit, duke përfshirë këtu porositë në faks, posta elektronike (e-mail) apo shërbimet e porosive të shkurtëra (SMS).

(6) Përkundër kushteve të tjera të këtij nëni, organizatat të cilat pranojnë thirrje emergjente mund të incizojnë dhe gjurmojnë ato thirrje për shkaqe të regjitrimit të thirrjeve emergjente apo identifikimit të thirrjeve bezdisëse.

(7) Nëse një radio sistem, paisje terminale apo paisje tjetër teknike pranon porosi të cilat nuk janë dedikuar për radio sistemin, paisjen terminale apo paisjet tjera teknike, përmbajtja e atyre porosive nuk duhet të incizohet apo shfrytëzohet për çfarëdo qëllimesh dhe duhet të fshihet apo shkatërrohet menjëherë.

Nëni 75

Të dhënat e trafikut

(1) Me qëllim të mbajtjes së shënimeve të sakta të faturimit, ofruesit e shërbimeve mund

të mbajnë dhe procesojnë të dhënat në vijim të trafikut deri në momentin kur janë paguar shërbimet, ka skaduar statusi i kufizimeve, gjeëgjësisht deri në momentin e vendimit për kërkesën në rast të konfliktit apo deri në momentin që urdhëri i gjyqit nuk bëhet i plotfuqishëm:

- (a) numri dhe identiteti i thirrësit dhe personit të thirrur;
- (b) adresa e parapaguesit dhe lloji i terminalit;
- (c) plani aplikativ i çmimeve;
- (d) totali i minutave të shfrytëzuara apo matje të ndonjë standardi tjetër;
- (e) lloji, data, koha dhe kohëzgjatja e thirrjes dhe/apo sasia e të thënave të transmetuara; apo
- (f) informata të tjera në lidhje me pagesën apo klasifikimin e pagesave, siç janë pagesat me avans, pagesat me rata, përkujtuesja për shfrytëzuesin, vërejtjet nga shfrytëzuesi dhe përgjigja për to, si dhe çkyqja e shfrytëzuesit.

(2) Të gjithëa të dhënat mbi trafikun dhe faturimin duhet të procesohen në pajtim me kërkesat e konfidencialitetit të nënit 74 (Konfidencialiteti) të këtij ligji apo ligjeve të tjera të aplikueshme dhe Rregulloreve të UNMIK-ut.

(3) Në rast të konfliktit, të dhënat e specifikuar në paragrafin (1) të këtij nëni do të jenë të hapura në formë të pashkurtuar për së paku 3 vite pas vendimit të organit mbi këtë konflikt.

(4) Të dhënat e trafikut që nëvojiten për faturim, menaxhim të trafikut, për informimin e shfrytëzuesve, për zbulimin e mashtrimit dhe për marketingun e vetë ofruesit të shërbimeve, mund të procesohen vetëm nga personëli nën mbikqyrjen e ofruesit të shërbimeve, dhe qasja e tyre në ato të dhëna do të jetë e kufizuar në minimumin e nëvojshëm për kryerjen e kësaj lloji detyre/pune.

(5) Ofruesit e shërbimeve që bëjnë tregëtimin e shërbimeve të tyre duhet të marrin pëlqimin/pajtimin e cilitdo person juridik apo fizik të dhënat e të cilit ata duan t'i përdorin për ato arsye.

Nëni 76

Kufizimet në mbledhjen dhe përdorimin e informatave të parapaguesve

(1) Ofruesit e shërbimeve publike të telekomunikacionit dhe rrjetave mund të mbledhin informatat vijuese personale mbi parapaguesit e tyre

- (a) emrin e plotë të parapaguesit , duke përfshirë edhe titullin akademik apo profesional të përdorur nga parapaguesi, nëse parapaguesi dëshiron ashtu;
- (b) emrin e bisnësit të parapaguesit dhe/apo emrin e njësisë organizative;
- (c) aktivitetet e parapaguesit, nëse parapaguesi ashtu dëshiron;
- (d) adresën e parapaguesit;
- (e) numrin e parapaguesit
- (f) informata shtesë nëse parapaguesi pajtohet dhe personat e tretë nuk ndikohen nga këto informata; dhe
- (g) numrin tatimor për personin fizik dhe numrin tatimor dhe numrin e regjistrimit për personin juridik.

(2) Ofruesit e shërbimeve mund t'i përdorin informatat mbi parapaguesit e tyre gjatë krijimit të kontratave, vendosjes së tarifës për shërbime, përgatitjes dhe publikimit të

adresarëve për parapaguesit dhe sigurimin e shërbimeve ndimëse.

(3) Adresarët e parapaguesve, të printuara apo elektronike, mund të përmbajnë të gjitha informatat e parapaguesve të specifikuara në këtë nen, sidoçoftë duke marrë parasysh që parapaguesi të japë lejen e tij me shkrim për publikimin e informative të tij. Informatat tjera të specifikuara në këtë nen mund të publikohen vetëm me lejen me shkrim të parapagesit

(4) Ofruesit e shërbimeve do të korigojnë, shtojnë, shlyejnë apo të rishkruajnë informatat që gjinden në adresar, me kërkesën e parapaguesve, pa pagesë, informatat në adresarë do të jetë të freskëta, dhe të dhënat në shërbimet ndihmëse për adresarë do të freskohen së paku 1 herë në muaj.

(5) Më kërkesën e një personi apo firme e cila dëshiron që të publikojë një adresar, ofruesi i shërbimeve, vetëm për një qëllim të tillë, do t'i sigurojë informatat mbi parapagesit që nuk i kanë kundërshtuar publikimit në adresar.

(6) Ofruesit e shërbimeve publike të telekomunikacionit dhe rrjetave do të sigurojnë informata pa pagesë mbi parapagesit për ART-in, ndërsa për personat tjerë me qmim të arsyeshëm dhe me kushte jo-diskriminuese.

(7) Me përfundimin e mardhënjes parapaguese, ofruesit e shërbimeve do ti ruajnë informatat e specifikuara në paragrafin (1) të këtij neni deri sa parapagesit t'i kryejnë detyrimet e tyre apo derisa të përmbyllen procedurat gjyqësore, dhe do t'i ruajnë faturat në përputhje me ligjin aplikativ.

Nëni 77 Gjurmimi i thirrjeve

(1) Ofruesit e shërbimeve dhe rrjetave publike të telekomunikacionit, në rast të thirrjeve bezdisëse apo atyre dëmtuese të bëra parapaguesve të tyre, mund të identifikojnë thirrësin, pa marrë parasysh pranimin/dëshirën e të dytit.

(2) Nëse parapaguesi kërkon gjurmimin e thirrjeve bezdisëse apo dëmtuese, ofruesi i shërbimeve dhe rrjetave publike të telekomunikacionit duhet të organizojë gjurmimin, apo për thirrjet e reja përkohësisht pamundësojë shfaqjen e numrit të identitetit të thirrësit.

(3) Ofruesi i shërbimeve do t'i ruaj informatat mbi gjurmimin dhe do t'ia përcjell ato parapagesit, duke marrë parasysh kushtet dhe mënyrën e specifikuar në këtë ligji, si dhe autoriteteve të Kosovës në lidhje me proceset preliminare dhe ato penale për mbrojtjen e sigurisë në Kosovë.

(4) Ofruesit e shërbimeve dhe rrjetave publike të telekomunikacionit duhet të pamundësojnë mundësinë e mos-shfaqjes së identitetit të thirrësit për lidhjet individuale në bazë të kërkesës së autoriteteve pëkatëse të Kosovës.

Kapitulli 14
Dispoziata përfundimtare

Neni 78
Implementimi

Qeveria do të nxjerrë akte normative që janë të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 79
Ligji aplikativ

Ky ligj do të zëvendësojë çdo dispozitë dhe çdo rregullore ekzistuese apo ligj aplikativ i cili nuk është në përputhje me të.

Neni 80
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes .

Ligji nr. 2002/7
8 Maj 2003

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Akademik Nexhat Daci